

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit MSc në "FARMACI"

UNIVERSITETI "ALDENT"

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof As. Brunilda Myftari

Prof As. Leonard Deda



(Shtator/2019)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit MSc në "Farmaci"

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti "Aldent"
2	Fakulteti që ofron	Fakulteti i Shkencave Mjekësore
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	UMASh Nr. 519, datë 19.11.2010
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	UMASh Nr. 248, datë 12.06.2013
5	Titulli i programit të studimit:	Master i Shkencave në Farmaci
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	5 vite/ 10 semestra
8	Kreditet në total (ECTS):	300 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
16	Nr i studentëve	281

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Msc në “Farmaci”

Universiteti Aldent e ushtron aktivitetin e tij bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe aktet ligjore e nënligjore mbi arsimin e lartë, Statutin e Universitetit, Rregulloren bazë të tij dhe në aktet e tjera rregullatore të institucionit. Fillimisht është hapur si Shkollë e Lartë Universitare jopublike (VKM Nr. 673, Dt 22.09 2006). Me VKM Nr. 539, Dt. 13.06.2013 u emërtua si Universiteti Aldent. Tashmë Universiteti "Aldent" ka tre Fakultete të profilit mjekësor.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u kontraktua nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) për të bërë vlerësimin e jashtëm periodik të Programit të Studimit Master i Shkencave në “Farmaci” ofruar nga Universiteti “ Aldent”. Qëllimi i procesit të vlerësimit të jashtëm është të japë një mendim të pavarur për shkallën në të cilën institucioni në fjalë është i përgatitur dhe i angazhuar të përmbushë me efektivitet dhe përgjegjshmëri kërkesat dhe standardet akademike të diplomave që do të lëshojë. Për të arritur në këtë gjykim, GVJ u mbështet në shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, në dokumentacionin bazë mbi të cilin ngrihet veprimtaria e Universitetit (statuti, rregullorja, etj), dosjen e programit të studimit, dokumentacionin e sekretarisë mësimore, takimet e vizitat e organizuara në institucion etj.

Programi i studimit **MSc në “Farmaci”** ofruar nga Universiteti Aldent, është licensuar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr. 519, dt 19.11.2010. Ky program ofrohet nga Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore. Është një program studimi i integruar i ciklit të dytë në "Farmaci" (5 vite akademike) dhe akredituar, si program i Studimit “Master i Shkencave” në Farmaci, në vitin 2013 me Vendim nr. 468 datë 03.05.2013.

Në vitin 2015 është diplomuar brezi i parë i studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në “Farmaci” pranë UAL. Deri më tani F.SH.M. ka diplomuar katër gjenerata studentësh.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ: Bordi i Akteditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën Prof.As. Brunilda MYFTARI dhe Prof.As. Leonard DEDA si ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi. Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga koordinatori teknik i ASCAL Xhiliola Bixheku.

Në datë 17.07.2019 dërgohet në Institucion Draft Raporti i Vlerësimit të jashtëm i Hartuar nga ekspertet e vlerësimit me anë të sistemin AMS të ASCAL. Më datë 30.07.2019 Institucioni sjell në ASCAL komentet në lidhje me Draft – RVJ. Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

Memo: Mbi komentet e bëra nga UAL në lidhje me RVJ për Programin e studimit MSc në “Farmaci”

Në vijim të korespondencës me IAL që ofron këtë program studimi GVJ vëren se Institucioni e ka tejkaluar të drejtën e tij për të bërë komente mbi RVJ.

Të kalosh me sukses disa akreditime nuk do të thotë apriori, që i përmbush kriteret ligjore dhe standartet në të njëjtën masë edhe në rivlerësimet që vijnë

Sygerimet e ekspertëve të jashtëm, për përmirësime të nevojshme, në aspekte të ndryshme të programit të studimit MSc në “Farmaci” të ofruar nga UAL janë bërë në frymën konstruktive me qëllimin për t’u ofruar studentëve të këtij institucioni standarte gjithnjë e më të larta.

Për sa më sipër mendojmë se RVJ paraqet situatën aktuale të këtij institucioni.

Grupi i ekspertëve të jashtëm pasi i shqyrtoi me kujdes e përgjegjshmëri të gjitha komentet e bëra nga UAL në lidhje me Raportin e Vlerësimit të Jashtëm mendon se:

- a) Për rekomandimin e parë, për periudhën 2013-2015 institucioni ka pranuar studentët e rinj në bazë të Udhëzimeve të MAS duke aplikuar si kriter notën mesatare dhe nuk ka evidenca për aplikim të kritereve të tjera. Nga ana tjetër në asnjë nga vitet akademike në shqyrtim nuk është bërë asnjë testim për të njohur nivelin e studentëve në fillim të Programit të studimit siç kërkon rekomandimi i lënë nga akreditimi i parë. ***Një e-mail qarkullues, propozim për mendim nga stafi, nuk mund të merret si fakt që është aplikuar.*** Pra për 2 vitet e para akademike pas akreditimit ky rekomandim nuk plotësohet. ***Duke marrë parasysh se mbas vitit 2015 kjo situatë rregullohet nga Udhëzimet e MASR mund të thuhet se nuk ishte më e nevojshme të plotësohet.***
- b) Për rekomandimin e dytë, institucioni ka bërë përpjekje për profilizimin e pedagogëve të lëndës, por mbetet problem mosprofilizimi i titullarëve të lëndëve. Titullarët firmosin 3-4 syllabuse dhe në disa prej tyre nuk janë të profilit dhe shpesh nuk kanë asnjë orë ngarkesë. Ky rekomandim përmbushet kryesisht.

Kur flitet për profilizim të stafit akademik sigurisht që merren parasysh si CV edhe botimet dhe na rezulton se një pjesë e titullarëve nuk kanë as background mësimdhënieje, as botime në disa nga fushat ku bën pjesë lënda për të cilën ata firmosin si titullarë.

GVJ shprehet se ky rekomandim plotësohet kryesisht.

- c) Për rekomandimin e tretë, institucioni ka shtuar ambjentet për programin e studimit Master i Shkencave në “Farmaci”, duke zhvendosur programet e tjera në një godinë në Kashar. Ka ambiente krijuese dhe ndihmëse siç është biblioteka. Biblioteka ka një pjesë të fondit në Godinën në Rrugën e Dibrës dhe një pjesë në Godinën në Kashar. Po ndërtohet kampusi i ri në periferi të Tiranës. Për Kampusin e ri nuk kemi të dhëna mbi sipërfaqen dhe ambjentet, por synohet të hapet për vitin akademik 2019-2020. GVJ mendon se ky rekomandim përmbushet plotësisht.

GVJ e ka përmendur si aspekt pozitiv për të ardhmen. GVJ heq frazën mbi kampusin.

Përsa i përket përmbushjes së standarteve

Standarti I.1 fq 5 GVJ shprehet se paragrafi mbetet siç është.

Standarti I.1 fq 6 Konstatimi se Programi i studimit është ndërtuar në përputhje me kërkesat e sektorit farmaceutik dhe zhvillimin ekonomik të vendit bazohet në të dhënat që vetë GVJ ka për këtë sektor dhe jo bazuar në studimin e tregut të punës të parashtruar nga GVB.

Standarti I.3 fq 6

Nëse ofrohet një lëndë e caktuar duhet dorëzuar edhe syllabusi përkatës gjë që nuk është bërë. GVJ shprehet se kjo është ose mungesë dokumentacioni ose thjesht neglizhencë e GVB. Në bazë të VKM Nr. 41 dt. 24.1.2018 shtojca nr.1 thuhet se lëndët ndërdisiplinore/integruese -nëndisiplina dhe grup-lëndët me zgjedhje duhet të jenë në masën 12-15% për Programe studimi Master i shkencave (i integruar) pra rreth 36-45 kredite në total.

Bazuar në VKM Nr. 41 dt. 24.01.2018 situata paraqitet si në tabelën e mëposhtme ku GVJ vëren se:

Kategoria	Tipi i komponentit mësimor	Master i Shkencave (i integruar)	Programi MSc Farmaci i ofruar nga UAL
A	Lëndë bazë	15%-20%	16%
B	Lëndë karakterizuese	45%-55%	51.7%
C	Lëndë ndërdisiplinore dhe grup-lëndë me zgjedhje	12%-15%	15.5%
D	Lëndë plotësuese	6%-8%	10,1%
E	Detyrime përmbyllëse	3%-5%	6.7%

*Përqindja totale e kategorive A dhe B nuk duhet të zerë më pak se 70% në programet Master i Shkencave i Integruar. Pra vihet re se në përqindje kategoria A+B zë 67.7%, ndërkohë që lëndët plotësuese e detyrimet përmbyllëse zenë një peshë më të lartë nga sa parashikohet në VKM.

7. GVJ shprehet se do ishte më mirë për studentin një planifikim më i zgjatur në kohë në mënyrë që ai të mos jetë i detyruar të praktikohet 8 orë në ditë në farmaci por duhet të ketë kohë edhe për të studiuar në lidhje me mikrotezën për mbrojtjen e diplomës.

8. Konstatimi i GVJ ka të bëjë me Programin e studimit në tërësi dhe jo lëndë të veçanta. Në një vit akademik është e kuptueshme që të ketë edhe lëndë që nuk kanë 50 % leksione apo lëndë të cilat kanë mbi 50% leksione e nuk kanë orë praktike.

9. Ndërkombëtarizimi realizohet në bazë të marrëveshjeve reciproke në nivel institucional, në mënyrë që t'u shërbejë sa më shumë studentëve. Edhe në tabelën e sjellë vërehet se janë vetëm 3 studentë që kanë përfituar nga këto marrëveshje.

10. Konstatimi qëndron, konsiderohet lapsus dhe reflektohet në RVJ final.

11. Konstatimi se *ka patur ndryshime të vazhdueshme të stafit akademik nuk është opinion*, por fakt që bazohet në tabelat e PAE dhe PAK të Departamenteve përgjatë gjithë periudhës 2013-2019 të përfshira në RVB.

12. Jemi dakort që raporti i numrit pedagog/student plotëson limitin e kërkuar. Bëhët reflektimi në RVJ final.

13. GVJ vëren se plotësohet kriteri i shpërndarjes së ngarkesës midis PAE/PAK 70%/30%, por jo ai në numër personeli akademik PAE/PAK. Tabela e përpiluar dhe dërguar si fakt, pjesë e komenteve të sjella nga institucioni ka gabime. GVJ ka bërë përditësimet në RVJ.
14. Vërejmë se Udhëzimi Nr. 36/d pika 6 i MASR lejon që ngarkesa e një pedagogu mund të plotësohet deri në 3 lëndë semestrale ose 2 lëndë vjetore dhe jo 3 module për semestër siç pretendohet.
15. Komenti është marrë pjesërisht në konsideratë nga GVJ dhe është reflektuar në RVJ final.
16. GVJ vëren se disa nga CV e ngarkuara në sistemin AMS të ASCAL lenë për të dëshiruar si në format, edhe përmbajtje. Rifreskimi i CV mbetet një rekomandim për tu përmirësuar.
17. GVJ shprehet se paragrafi mbetet i pandryshuar.
18. GVJ shprehet se paragrafi mbetet i pandryshuar.
19. Komenti është marrë në konsideratë dhe reflektohet në RVJ final.
20. Konstatimi ka të bëjë me çka na u prezantua ditën e vizitës dhe është fakt.
21. GVJ vizitoi vetëm katin 9 dhe 10 në lidhje me hapësirat në dispozicion të procesit mësimor.
22. Komenti është marrë pjesërisht në konsideratë nga GVJ dhe është reflektuar në RVJ final.
23. Komenti është marrë në konsideratë dhe reflektohet në RVJ final.
24. GVJ nuk pajtohet me mendimin se punët për të tretë do të sillnin vetëm punë rutinë e ulje të kohës për kërkim shkencor, përkundrazi.
25. Biokimia klinike mund të kategorizohet si e tipit B, por ajo mjekësore duhet t'u japë studentëve njohuritë bazë në këtë fushë e për këtë arsye duhet konsideruar me karakter të përgjithshëm. Komenti është marrë pjesërisht në konsideratë nga GVJ dhe është reflektuar në RVJ final.
26. Keqinterpretim nga komentuesit. Bëhet fjalë për numrin e personelit akademik dhe jo mbulimin e ngarkesës. Komenti është marrë pjesërisht në konsideratë nga GVJ dhe është reflektuar në RVJ final.
27. Komenti është marrë në konsideratë dhe reflektohet në RVJ final.
28. Komenti është marrë në konsideratë dhe reflektohet në RVJ final.
29. Në lidhje me punësimin e studentëve na rezulton se nuk i kanë të plota. Ka të dhëna vetëm për 62% të ish-studentëve. Paragrafi nuk ndyshon.
30. Komenti është marrë në konsideratë dhe reflektohet në RVJ final.



ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

- a) Të zbatohen kritere për pranimin e studentëve të rinj dhe të kryhet një test pranimi për të njohur nivelin e tyre në fillimin e Programit të studimit.
- b) Të rritet numri i stafit të profilizuar që angazhohet me kohë të plotë në realizimin e Programit të studimit, përpara diplomimi të brezit të parë (2013)
- c) Të krijohen mjedise të përshtatshme ndihmëse dhe creative për të zhvilluar sa më mirë aktivitetin mësimor.
- d) Të sigurohet që studentët e këtij program studimi të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- d) Për rekomandimin e parë, institucioni ka pranuar studentët e rinj në bazë të Udhëzimeve të MAS duke aplikuar si kriter notën mesatare dhe nuk ka evidenca për aplikim të kritereve të tjera. Nga ana tjetër në asnjë nga vitet akademike në shqyrtim nuk është bërë asnjë testim për të njohur nivelin e studentëve në fillim të Programit të studimit. Mund të thuhet se ky **rekomandim për vitet akademike 2013-2014 dhe 2014-2015 nuk përmbushet**, ndërsa **pas vitit 2015 me hyrjen në fuqi të Ligjit 80/2015 mbi Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë këto kritere rregullohen nga MAS.**
- e) Për rekomandimin e dytë, institucioni ka bërë përpjekje për profilizimin e pedagogëve të lëndës, por mbetet problem mosprofilizimi i titullarëve të lëndëve. Titullarët firmosin 3-4 syllabuse dhe në disa prej tyre nuk janë të profilit dhe shpesh nuk kanë asnjë orë ngarkesë. **Ky rekomandim përmbushet kryesisht.**
- f) Për rekomandimin e tretë, institucioni ka shtuar ambjentet për programin e studimit Master i Shkencave në “Farmaci”, duke zhvendosur programet e tjera në një godinë në Kashar. Ka ambjente krijuese dhe ndihmëse siç është biblioteka. Biblioteka ka një pjesë të fondit në Godinën në Rrugën e Dibrës dhe një pjesë në Godinën në Kashar. GVJ mendon se ky **rekomandim përmbushet plotësisht.**
- g) Për rekomandimin e katërt, institucioni ka aplikuar Udhëzimin e MAS për mbrojtjen e gjuhës së huaj nga studentët e këtij program studimi para diplomimit të tyre, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. **Ky rekomandim përmbushet plotësisht.**

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Misioni dhe objektivat e Universitetit "Aldent" siç theksohet në statutin e tij janë të ofrojë arsimim të lartë dhe veprimtari krijuese në fushën mjekësore; të zhvillojë dijen përmes mësimdhënies akademike; të formojë studiues të rinj në fushat e programeve të studimit që ai ofron si dhe të thellojë kualifikimin profesional e shkencor të specialistëve të lartë të shëndetësisë.

Strategjia e programit të studimit Master i Shkencave në "Farmaci" bazuar edhe në misionin, që i ka vënë vetes institucioni ka si objektiv përmirësimin e sistemit laboratorik dhe zgjerimin e infrastrukturës. Si strategji afatgjatë ky program studimi përcakton ndërkombëtarizimin dhe përshtatshmërinë me kërkesat e tregut. *GVJ shpreh mendimin se* objektivi kryesor i programit të studimit duhet të jetë pikërisht formimi i specialistëve të shëndetësisë të përshtatshëm për plotësimin e kërkesat e tregut të punës, pra në fushën e shërbimit farmaceutik, në shërbimin profesional ndaj pacientëve dhe jo të lihej si objektiv afatgjatë. Mendojmë se kjo gjë do të përputhej më shumë me programin mësimor që ofrohet nga Institucioni.

Universiteti "Aldent" në strategjinë e tij afatgjatë ka si synim ndërkombëtarizimin e programeve të studimit dhe ka një marrëveshje të nënshkruar midis Qendrës Kërkimore Farmakoterapeutike dhe Departamentit të Farmacisë, Universiteti i Chieti-Pescara-Itali në kuadër të programit Erasmus + në vitin 2018, në periudhën para aplikimit për riakreditim të këtij programi studimi. Theksojmë se programi studimor shpreh vullnetin e institucionit në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	Programi i studimit Master i Shkencave në "Farmaci" është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit. Në statutin e universitetit theksohet se misioni i tij është të ofrojë arsimim të lartë në fushën mjekësore, që të realizojnë synimet e tyre profesionale brenda e jashtë vendit. Në zbatim të misionit dhe qëllimeve të IAL edhe për Programin e studimit Master i Shkencave në "Farmaci" specifikohet misioni në fushën farmaceutike për formimin e specialistëve në shërbimin farmaceutik të rrjetit të hapur, atij spitalor, administratës shëndetësore etj. GVJ shpreh mendimin se kjo gjë është në përputhje të plotë edhe me programin mësimor që ofrohet nga Institucioni. Bazuar në RVB institucioni deklaron se ka ndërmarrë dhe realizuar një studim të tregut të punës në të cilin nuk ka të dhëna konkrete mbi tregun e punës në fushën farmaceutike.
Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	
Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	

por vetëm opinione e perceptime. Kështu që GVJ mendon se ky studim tregu nuk mund të përbëjë një bazë për përcaktimin e kuotave të pranimit për këtë program studimi. Megjithatë nga njohuritë dhe të dhënat që GVJ zotëron mbi sektorin farmaceutik dhe shëndetësor në Shqipëri shpreh mendimin se programi i studimit është i ndërtuar në përputhje me kërkesat e sektorit farmaceutik dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.

Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit; Programi i studimit “Master i Shkencave në Farmaci” është hartuar në përputhje me strategjinë afatgjatë për zhvillimin e institucionit.

Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Në ndërtimin dhe përmbajtjen e programit të studimit janë bërë përpjekje për zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga akreditimi i parë.

Programi i studimit është i ndërtuar me lëndë dhe module përbërëse.

➤ Bazuar në VKM 41 datë 24.1.2018 GVJ vëren se

Kategoria	Tipi i komponentit mësimor	Master i Shkencave (i integruar)	Programi MSc Farmaci i ofruar nga UAL
A	Lëndë bazë	15%-20%	16%
B	Lëndë karakterizuese	45%-55%	51.7%
C	Lëndë ndërdisiplinore dhe grup-lëndë me zgjedhje	12%-15%	15.5%
D	Lëndë plotësuese	6%-8%	10,1%
E	Detyrime përmbyllëse	3%-5%	6.7%

Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;

Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.

*Përqindja totale e kategorive A dhe B nuk duhet të zerë më pak se 70% në programet Master i Shkencave i Integruar. Në këtë program studimi lëndët e kategorisë A+B zënë 67.7%, ndërkohë që lëndët plotësuese e detyrimet përmbyllëse zenë një peshë më të lartë nga sa parashikohet në VKM përkatësisht 10.1% nga 6-8% dhe 6.7% kundrejt 3%-5% .

➤ Sipas Planeve mësimore të dorëzuara 2013-2019 ofrohen 7 lëndë me zgjedhje, ndërkohë që nga vizita në institucion u saktësua se vetëm 2 prej tyre janë aktive dhe studentët pjesëmarrës ndahen me marrëveshje midis tyre dhe departamentit. *Lëndët me zgjedhje së bashku me lëndët ndërdisiplinore zenë 15.5% (Udhëzimi 41 dt. 24.1.2018 rekomandon 12-15%). Nga ana tjetër cilësimi i tyre në planin mësimor si Grupime të gjera lëndësh të cilat janë zhvilluar në vitet pararendëse nuk jep një ide të qartë për studentin se çfarë të rejash do studiojë në këto lëndë. Në këtë kuadër këto lëndë nuk kanë as syllabus, as pedagog lënde, as titullar, bazuar në programin*

	<p><i>mësimor 2018-2019 të përfshirë në DVV.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Praktika profesionale zhvillohet në disa faza, gjatë semestrit të parë dhe të dytë të vitit të V. Zakonisht fillon në Dhjetor ndërpritet për pushimet e dimrit, më pas në Janar ndërpritet nga sezoni i dimrit i provimeve dhe më pas në Mars dhe përfundon midis 29-31 Marsit duke përbushur 520 orë në total me 25 ECTS. Për të plotësuar këto orë studenti duhet të zhvillojë 8 orë praktikë në ditë. GVJ sygjeron të shpërndahet në një kohë më të gjatë praktika profesionale në mënyrë që studenti siç parashikohet në Nenin 11 pika 5 të Rregullores së Programit të Studimit Master i Shkencave në “Farmaci” në bashkëpunim të ngushtë me udhëheqësin dhe departamentin të punojë për temën e diplomës. ➤ Tema e diplomës është 20 kredite konform udhëzimit përkatës. ➤ Në vitin e tretë, të katërt dhe të pestë në planin mësimor të rishikuar 2018-2023 leksionet të llogaritura në % përbëjnë më pak se 50% të totalit. Ky raport vërehet edhe në Tabelën Nr.9 “Ngarkesa totale në auditor për Format e mësimdhënies në programin e studimit” <p>Emërtimi i programit në dokumentin e akreditimit është në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimit.</p>
--	---

Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p><i>Institucioni në strategjinë e tij afagjatë synon në radhë të parë përmirësimin e sistemit laboratorik dhe zgjerimin e infrastrukturës edhe pse kjo është një nga pikat e forta që ky institucion i rrethon, laboratorët e bollshëm e të pajisur me aparatura moderne.</i></p> <p>Universiteti “Aldent” në strategjinë e tij afagjatë ka si synim ndërkombëtarizimin e programeve të studimit, por deri në vitin 2018-2019 ka vetëm një marrëveshje të nënshkruar midis Qendrës Kërkimore Farmakoterapeutike dhe Departamentit të Farmacisë, Universiteti i Chieti-Pescara-Itali në kuadër të programit Erasmus + në vitin 2018, pra në periudhën para aplikimit për riakreditim të këtij programi studimi.</p> <p>Universiteti vlerëson për çdo vit akademik mësimdhënien nëpërmjet Raportit Vjetor të NJBSC bazuar në pyetësorët e organizuar me studentët, si dhe rezultateve të marra nga formularët e performancës së stafit akademik, me mbështetjen e Drejtuesit të njësisë bazë.</p>
---	---

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Bazuar në RVB si dhe bazuar në vizitën në institucion dhe dokumentet shtesë të përftuara gjatë vizitës, GVJ vlerëson se programi i studimit Master i Shkencave në “Farmaci” është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit, i cili theksohet në statutin e universitetit për të krijuar specialistë të aftë për profesionet shëndetësore.
2. Ndërtimi dhe përmbajtja e programit të studimit në përgjithësi është në përputhje me aktet dhe nënaktet ligjore përkatëse duke iu referuar Udhëzimit Nr. 41 Dt. 24.01.2018. GVJ sygjeron një rishikim për t'i shpërndarë lëndët e kategorive A,B,C,D,E në përqindjen e kërkuar.
3. GVJ sygjeron rritjen e numrit të marrëveshjeve me institucione të huaja të arsimit të lartë për

t'u dhënë mundësi një numri sa më të madh studentësh dhe pedagogësh të përfitojnë prej tyre. Kjo do t'i shërbente rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Programi i studimit master i shkencave në “Farmaci” i ofruar nga Shkolla e Lartë Universitare Jo-Publike “Aldent” u akreditua me **Urdhër Nr.468 dt. 03.05.2013**. Më pas me **Urdhër Nr.305 dt 24.7.2013** të MAS është miratuar riorganizimi i Universitetit “Aldent” me dy fakultete Fakulteti i Shkencave Dentare dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore ku ky i fundit përbëhej nga 3 departamente përkatësisht:

1. Departamenti i Farmacisë;
2. Departamenti i Infermierisë e Fizioterapisë
3. Qendra kërkimore farmako-terapeutike.

Me vendim **Nr. 539, dt 13.06.2013** është miratuar ndryshimi i statusit nga shkollë e lartë universitare private në Universitet “Aldent”.

Së fundi në zbatim të Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë” me **Vendim Nr.115 dt 13.3.2017** Universiteti “Aldent” përbëhet nga 3 Fakultete dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore përbëhet nga 3 departamente si më poshtë:

1. Departamenti i Farmacisë,
2. Departamenti i Formimit Mjekësor
3. Qendra Kërkimore Farmako-terapeutike.

Autoritetet drejtuese janë: Rektori, Dekani, Përgjegjësi i Departamentit dhe Administratori.

Organet kolegjiale drejtuese janë: Senati akademik, Asambleja e Stafit Akademik.

Fakulteti i Shkencave Mjekësore përbëhet nga tre Departamente dhe çdo departament ka të paktën 7 anëtarë me kohë të plotë, nga të cilët minimumi 3 me gradë/titull akademik. Me Vendim nr. 52 të Senatit Akademik në 30 Dhjetor 2016 insitucioni ka hartuar edhe statutin e ri në përputhje me Ligjin e ri nr. 80/2015 dt 22.07.2015 të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor. (Shtojca nr 5)

Njësia shërben si bazë e realizimit, monitorimit dhe vlerësimit të procesit mësimor. Ajo merr pjesë direkt në këto procese dhe përcjell mendimet nëpërmjet përfaqësuesve të vet në hallkat akademike dhe administrative. Përgjegjës për këto procese është drejtuesi i departamentit, i cili ruan edhe database-in e të dhënave të departamentit.

Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Farmaci” në RVB thuhet se miratohet nga titullari i Njësisë Kryesore dhe Rektori i Universitetit “Aldent”.

Nga ana tjetër edhe një pjesë e CV-ve të stafit duhen rifreskuar.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit

Bazuar në DVV dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion GVJ vëren se Fakulteti i Shkencave Mjekësore përbëhet nga dy Departamente dhe çdo departament ka jo më pak se 7 anëtarë me kohë të plotë, nga të cilët minimumi 3 me gradë/titull akademik dhe një Qendër Kërkimore me 6 anëtarë me kohë të plotë, pasi muajin e fundit një nga anëtarët është larguar dhe 1 anëtar me diplomë Bachelor si personel ndihmës-akademik.

- Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Departamenti i Farmacisë

- a) Për vitin akademik 2013-2014 sipas RVB Departamenti përbëhet nga 9 personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët; 3-Prof.Asc, 1-Dr dhe 5-Msc, pra 5 me grada/tituj konform kriterit të kërkuar
- b) Për vitin akademik 2014-2015 sipas RVB Departamenti përbëhet nga 7 personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët 4 grada/ tituj.
- d) Per vitin akademik 2015-2016 sipas RVB Departamenti përbëhet nga 7 personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët 4 grada/tituj.
- e) Për vitin akademik 2016-2017 sipas RVB Departamenti përbëhet nga 7 personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët 3 grada/tituj.
- f) Për vitin akademik 2017-2018 sipas RVB Departamenti përbëhet nga 7 personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët 3 grada/tituj.
- e) Për vitin akademik 2018-2019 sipas RVB Departamenti përbëhet nga 7 personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët 3 Dr. (Tabela 1 RVB fq 11)

Vihet re se ky departament në vitin akademik 2018-2019 ka vetëm 3 Dr. Ndërkohë që në akreditimin e parë vitin 2013-2014 ka patur 3 Prof. As. dhe 1 Dr.

Qendra Kërkimore Farmakoterapeutike

Bazuar në RVB për vitin akademik 2018-2019 Q.K.F. përbëhet nga një total prej 8 PAE nga të cilët 1-Prof.Dr, 2 –Dr, 1- Spa, 3 –Msc dhe 1- Ba si punonjës ndihmës –akademik.

Bazuar në Ligjin 80/2015 punonjësi ndihmës- akademik me diplomë Bachelor mund të jetë pjesë e një Departamenti, por nuk mund të ushtrijë aktivitet mësimdhënies në një program studimi Master i Shkencave. Nëse Qendra Kërkimore nuk përmbush kriteret e njësisë bazë nuk llogaritet për qëllimin e përmbushjes së standarteve institucionale.

Edhe në vitin akademik 2014-2015 ka patur 7 pedagogë, në vitin akademik 2015-2016 nga 7 pedagogë të një viti më parë njëri kalon tek dega mësimore, në 2016-2017 QKF nuk ka më personel të degës mësimore, por nga 7 personel me kohë të plotë, njëri është nëpunës për marrëdhëniet me jashtë. Pra kjo qendër ka patur vazhdimisht një personel të paqëndrueshëm.

- Departamenti i Formimit Mjekësor

Për vitin akademik 2018-2019 Departamenti ka një total prej 7 PAE nga të cilët; 1-Prof.Asc, 2-Dr, 2-Spa dhe 2 –Msc nga të cilët 1 Msc konsiderohet si nëpunës për marrëdhëniet me jashtë.

Vihe re se nga njëri vit akademik në tjetrin stafi akademik i brendshëm i Departamentit të Farmacisë, ka patur ndryshime në numër, emra dhe grada/tituj akademikë. Kështu numri i PAE me tituj dhe grada është ulur në vitin e fundit 2018-2019 (3) në krahasim me atë të vitit akademik 2013-2014 (5). Ndryshime ka patur në kuadër të të gjithë F.Sh.M. (Tabela 4.1).

Shënim. Tabelat e ndryshme në lidhje me stafin akademik të programit të studimit në gjuhën e shifrave me ato që paraqesin listën emërore nuk përputhen. Kështu personelit akademik efektiv për programin e studimit, një listë sipas RVB Tabela 3 për vitin akademik 2013-2014 ka 16 PAE për programin e studimit, kurse në Tabelën 5 në RVB sipas moshës rezultojnë 21 PAE, 10 PAK kundrejt 15, etj (shih Tabelën 4.2).

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>Për vitin akademik 2014 -2015 insitucioni është riorganizuar me Urdhër Nr.305 dt 24.7.2013 ku Fakulteti iShkencave Mjekësore përbëhej nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Farmacisë, 2. Departamenti i Fizioterapisë dhe Infermerisë 3. Qendër Kërkimore Farmakoterapeutike <p>Për vitin akademik 2017- 2018 Institucioni është organizuar në përputhje me Ligjin 80/2015 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor” në fuqi. Sipas urdhërit të MAS Vendim Nr.115 dt 13.3.2017 Universiteti “Aldent” është riorganizuar në tre njësi kryesore konkretisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fakulteti i Shkencave Dentare 2. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike 3. Fakulteti i Shkencave Mjekësore <p>I cili përbëhet nga</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Departamenti i Farmacisë, b) Departamenti i Formimit Mjekësor c) Qendër Kërkimore Farmakoterapeutike <p>Këtë riorganizim e ka pasqyruar edhe në statutin e ri.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore ka në përbërje tashmë dy Departamente dhe një Qendër Kërkimore. Çdo departament ka të paktën 7 anëtarë me kohë të plotë, nga të cilët minimumi 3 me gradë/titull akademik.</p> <p>Bazuar në RVB për vitin akademik 2018-2019 Q.K.F. përbëhet nga një total prej 8 PAE nga të cilët 1-Prof.Dr, 2 –Dr, 1- Spa, 3 –Msc dhe 1- Ba si punonjës ndihmës –akademik.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion u konstatua se J.Gj. PhD ishte larguar një muaj më parë, tashmë punonte si PAK pranë F.SH.M.. Kjo krijon një boshllëk që</p>

	<p>Institucioni nuk e kishte zëvendësuar akoma. Bazuar në Ligjin 80/2015 punonjësi ndihmës-akademik me diplomë Bachelor mund të jetë pjesë e një Departamenti, por nuk mund të ushtrojë aktivitet mësimdhënies në një program studimi Master i Shkencave. Nëse Qendra Kërkimore nuk përmbush kriteret e njësive bazë nuk llogaritet për qëllimin e përmbushjes së standarteve.</p> <p>Bazuar në RVB dhe në dokumentacionin mbështetës, Departamenti i Farmacisë</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ për vitin akademik 2013-2014 përbëhet nga 9 personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët; 3-Prof.Asc, 1-Dr dhe 5-Msc, pra 5 me grada/tituj konform kriterit të kërkuar ✓ për vitin akademik 2014-2015 përbëhet nga 7 personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët 4 grada/ tituj. ✓ për vitin akademik 2015-2016 përbëhet nga 7 personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët 4 grada/tituj. ✓ për vitin akademik 2016-2017 përbëhet nga 7 personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët 3 grada/tituj. ✓ për vitin akademik 2017-2018 përbëhet nga 7 personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët 3 grada/tituj. ✓ për vitin akademik 2018-2019 përbëhet nga 7 personel akademik efektiv(PAE) nga të cilët 3 Dr. (Tabela 1) <p><i>Vihet re se ky departament në vitin akademik 2018-2019 ka vetëm 3 Dr. nga 7 gjithsej. Ndërkohë që në akreditimin e parë vitin 2013-2014 ka patur 3 Prof. As. dhe 1 Dr nga 9 gjithsej.</i></p> <p><i>Gjithashtu vihet re se nga viti akademik 2017- 2018 në vitin 2018-2019 ka një ulje në numrin e stafit akademik efektiv dhe me kontratë.</i></p>
--	---

Standardi II.3 - Njësiti e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Njësiti bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësiti bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Njësiti bazë angazhohen drejtpërdrejt me përgjegjshmëri në realizimin e programit të studimit siç janë propozimi i kuotave, parashikimi i ngarkesës, propozime për ndryshime kurrikulare, raport vjetor në lidhje me aspektet akademike dhe organizative në nivel programi studimi, propozim për rekrutimin e stafit etj.</p> <p>Njësiti bazë realizojnë vlerësimin e stafit akademik nëpërmjet kriterëve dhe standarteve të përshkruara në formularin përkatës, i cili plotësohet për çdo pedagog dhe vendoset në dosjen personale, e cila arkivohet në departament.</p>
--	--

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Bazuar në RVB, dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion GVJ vlerëson se UAL në përgjithësi dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore në veçanti janë të organizuara në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Departamenti i Farmacisë përbëhet nga jo më pak se 7 anëtarë me kohë të plotë, nga të cilët minimumi 3 me gradë/titull akademik. Përbërja e departamentit të Farmacisë paraqitet për vitin akademik 2018-2019 me 7 anëtarë nga të cilët 3 Dr., ndërkohë që në 2013-2014 ka patur 9 PAE nga të cilët 1 Prof.Dr, 3 Prof. As. dhe 1 Dr.

2. Për sa i përket realizimit të programit mësimor GVJ vlerëson se Departamenti i Farmacisë angazhohet drejtpërdrejt dhe realizon vlerësimin e stafit akademik nëpërmjet kriterëve dhe standarteve të përshkruara në formularin përkatës. Ky formular dhe vlerësimi i përgjegjës të Departamentit vendoset në dosjen personale të çdo pedagogu dhe arkivohen në departament. *Nga cilësia e të dhënave të përfshira në DVV dhe dokumentacionit shtesë të sjellë pas vizitës, vihet re mosrifreskim i tyre.*
3. *Gjithashtu vihet re se nga viti akademik 2017- 2018 në vitin 2018-2019 ka një ulje në numrin të stafit akademik efektiv dhe me kontratë.*

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Për vitin akademik 2013-2014 në këtë program studimi janë angazhuar gjithsej **26 pedagogë**, nga të cilët **16** janë Personel Akademik Efektiv (PAE), nga ku **1 Prof, 4 Prof.Asc. 1 Dr. dhe 10 Msc**, dhe **10** janë Personel Akademik me Kontratë (PAK) nga ku **1 Prof, 3 Prof.As, 0 Dr, dhe 6 Msc**.

Ndërkohë për vitin akademik 2014-2015 programi i studimit realizohej nga **40 pedagogë** gjithsej, nga të cilët **19** ishin Personel Akademik Efektiv (PAE) nga ku **3 Prof., 2 Prof. As., 6 Dr dhe 8 Msc**, dhe **21** ishin Personel Akademik me Kontratë (PAK) nga ku **4 Prof, 5 Prof.As, 5 Dr dhe 7 Msc**. Vihet re se në vitin akademik 2014-2015 ka një rritje të stafit akademik PAE për realizimin e ngarkesës mësimore pasi ka një rritje me gati **25%** të numrit të studentëve (**54 studentë**) në krahasim me vitin akademik paraardhës.

Për vitin akademik 2015-2016 programi i studimit realizohej nga **37 pedagogë** gjithsej, nga të cilët **21** ishin Personel Akademik Efektiv (PAE) nga ku **3 Prof., 4 Prof. As., 6 Dr dhe 7 Msc**, dhe **16** ishin Personel Akademik me Kontratë (PAK) nga ku **2 Prof, 4 Prof.As, 5 Dr dhe 5 Msc**. Vihet re se në vitin akademik 2015-2016 ka një rritje të stafit akademik PAE me tituj dhe grada për realizimin e ngarkesës mësimore.

Për vitin akademik 2016-2017 personeli akademik për realizimin e programit përbëhej nga **38 pedagogë**. nga të cilët **18** ishin Personel Akademik Efektiv (PAE) nga ku **3 Prof., 3 Prof. As., 5 Dr., dhe 7 Msc.**, ndërkohë që **20** ishin Personel Akademik me Kontratë (PAK) nga ku **3 Prof, 3 Prof.As, 7 Dr., 1 Spa dhe 6 Msc**.

Për vitin akademik 2017-2018 programi i studimit realizohej nga **36 pedagogë** gjithsej, nga të cilët **20** ishin Personel Akademik Efektiv (PAE) nga ku **2 Prof., 4 Prof. As., 7 Dr. dhe 7 Msc**, dhe **16** ishin Personel Akademik me Kontratë (PAK) nga ku **2 Prof, 5 Prof.As., 7 Dr., 1 Spa dhe 1 Msc**.

Bazuar në RVB dhe gjetjet gjatë vizitës në institucion për vitin akademik 2018-2019 programi i studimit po realizohet nga **34 pedagogë** gjithsej, nga të cilët **15** semestri I (**14** semestri i II) ishin Personel Akademik Efektiv (PAE) nga ku **1 Prof., 3 Prof. As., 6 Dr. Semestri I (5 Dr. Semestri i II) dhe 5 Msc.**

dhe 19 semestri I (20 semestri II) ishin Personel Akademik me Kontratë (PAK) nga ku 2 Prof, 6 Prof.As, 8 Dr.semestri I (9 semestri i II), 1 Doc., 1 Spa dhe 1 Msc.

Shpërndarja e ngarkesës është e tillë që mbi 2/3 e saj realizohet dhe mbulohet nga stafi me kohë të plotë, por jo në të gjitha rastet në përputhje me profilin e fushës së vet, madje një pedagog mbulon ngarkesë mësimore në disa lëndë të ndryshme. Vihet re se me tendencën që orët të zhvillohen nga stafi i brendshëm këta të fundit janë mbingarkuar me orë në lëndë e module të ndryshme.

Për vitin akademik 2013-2014 ngarkesa mësimore realizohet në masën **68.76%** nga staf me kohë të plotë (**kriteri mbi 70% të ngarkesës**) dhe përsa i përket kriteri i raportit PAE/PAK mbi 70%, në këtë vit akademik nuk plotësohet, ka qenë **61.5% (Tabela – 1, 5)**;

Viti 2014-2015 **65.7%** e ngarkesës realizohet nga PAE dhe 34.3% nga PAK dhe raporti në numër PAE/PAK është **47.5%**;

Viti 2015-2016 paraqet një hop cilësor pasi plotësohet kriteri i mbulimit të ngarkesës nga PAE me **73.71%** dhe raporti i personelit akademik bëhet **56.75%**;

Viti akademik 2016-2017 ulet sërish nën kriterin ligjor **66.11%** e ngarkesës nga PAE dhe raporti PAE/PAK bëhet **47.36%**;

Viti akademik 2017-2018 sërish përmirësohet situata pasi **79.5%** e ngarkesës mësimore realizohet nga stafi i brendshëm dhe i ftuar i departamentit të farmacisë dhe vetëm 20.5% nga ai me kontratë. Përsa i përket raportit PAE/PAK ende nuk plotësohet kriteri 70%, mbetet **55.55%**;

Për vitin akademik 2018-2019 mund të thuhet se **73%** e ngarkesës realizohet nga PAE dhe 27% nga PAK. Raporti PAE/PAK për këtë vit është përkeqësuar **42.8%**. *Pra realizohet kriteri i ngarkesës.*

Në dritën e të dhënave më sipër GVJ vëren se është ruajtur një balancë gjatë 6 viteve akademike në lidhje me ngarkesën mësimore, e cila është realizuar mbi 60% nga PAE dhe nën 40% nga PAK. Gjatë vitit 2015-2016, 2017-2018 dhe 2018-2019 është përmbushur kriteri mbi 70%. Pra kriteri i ngarkesës plotësohet në 3 nga 6 vitet në shqyrtim.

Llogaritja e ngarkesës mësimore në raport me koeficientët përkatës përgjithësisht është zbatuar për të gjitha veprimtaritë, në ngarkesën mësimore për vitin akademik 2018-2019. Në ngarkesën e stafit akademik vërehet se 8 nga 15 PAE kanë ngarkesë mbi 300 orë mësimore, 3 prej tyre mbi 400 orë dhe 1 PAE ka ngarkesë mbi 600 orë mësimore. Gjatë vizitës na u deklarua se për ndarjen e ngarkesës zbatohet *Udhëzimi Nr. 29, Dt 10.09.2018 i MASR. Në këtë udhëzim ngarkesa e stafit akademik Prof. është 140 orë, Lektore 165 orë, asistent lektore 195 orë dhe mund të bëjë deri 200 orë mbingarkesë, apo në raste të rralla edhe 100 orë me miratim të veçantë.*

Bazuar në RVB, takimin me përgjegjësen e Departamentit dhe Burimet Njerëzore, stafi akademik rekrutohet në bazë të disa kriterëve të përgjithshme si Grada/ Titulli akademik, Botimet shkencore, eksperiencia në punë etj. Departamenti ka një tabelë pikëzimi që e përdor gjatë konkurrenive ku një vend i veçantë i lihet edhe intervistës së kandidatëve. *Për vitin akademik 2018-2019 në Departamentin e Farmacisë janë rekrutuar 2 pedagogë të rinj, nga të cilët asnjë nuk ka gradë shkencore, njëra ka qenë PAK në këtë institucion, ndërsa tjetri në bazë të CV të sjellë nga IAL pranë ASCAL nuk ka eksperiencë në fushën ku ka ngarkesë mësimore.*

Institucioni ka 3 tipe kontratash për personel akademik efektiv, personel akademik me kontratë, si dhe personel ndihmës akademik apo administrativ. Ngarkesa mësimore është pjesë e aneks kontratës.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Tabelat në Aneks)

Bazuar në DVV Për vitin akademik 2017-2018 programi i studimit realizohej nga 36 **pedagogë** gjithsej, nga të cilët 20 ishin Personel Akademik Efektiv (PAE) nga ku 2 Prof., 4 Prof. As., 7 Dr. dhe 7 Msc, dhe 16 ishin Personel Akademik me Kontratë (PAK) nga ku 2 Prof, 5 Prof.As., 7 Dr., 1 Spa dhe 1 Msc.

Bazuar në RVB dhe gjetjet gjatë vizitës në institucion për vitin akademik 2018-2019 programi i studimit po realizohet nga 34 **pedagogë** gjithsej, nga të cilët 15 semestri I (14 semestri i II) ishin Personel Akademik Efektiv (PAE) nga ku 1 Prof., 3 Prof. As., 6 Dr. Semestri I (5 Dr. Semestri i II) dhe 5 Msc, dhe 19 semestri I (20 semestri II) ishin Personel Akademik me Kontratë (PAK) nga ku 2 Prof, 6 Prof.As, 8 Dr.semestri I (9 semestri i II), 1 Doc., 1 Spa dhe 1 Msc.

Vihet re ulje e numrit të stafit akademik efektiv nga 20 në 14, nga ku -1 Prof.Dr., -1 Prof.As., -1Dr., -1 PhD., -2 Msc.), ndërkohë që numri i studentëve të regjistruar për herë të parë në vitin e parë është 65 viti 2017-2018 dhe 67 viti 2018-2019.

- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatorit/ët e programit të studimit (**Tabela 3**)

Në bazë të RVB Këshilli Shkencor i programit të studimit përbëhet nga 7 anëtarë me gradën Dr e lart, nga të cilët 1 anëtar është pedagog me kontratë. Në zbatim të Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor” Koorditore e programit të studimit është Përgjegjësj e Departamentit të Farmacisë me gradën shkencore “Doktor i Shkencave”.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Plotëso Tabelat në Aneks, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)

Në RVB deklarohen të dhënat e vitit akademik 2018-2019, të cilat pasqyrohen në tabelën më poshtë:

Titulli/Grada	PAE	PAK	Raportet midis tyre
Profesorë	1	2	1 / 2
Profesorë të As	3	6	3 / 6
Dr./PhD	5	9	5 / 9
Msc.	5	1	5 / 1
Doc	0	1	0 / 1
Spa	0	1	0 / 1

GVJ vëren se aktualisht stafi PAK ka në përbërje 19/20 persona me grada e tituj akademikë, ndërkohë që stafi PAE ka 9/14 me tituj e grada, pra stafi me kontratë rezulton më i kualifikuar.

Për të dhëna në lidhje me periudhën 6-vjeçare midis akreditimeve jepen **Tabelat nr.4-4.3)**

- Të dhënat sipas seksit (Plotëso Tabelat në Aneks, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)

Bazuar në RVB, Tabela 3, raporti meshkuj femra për personelin akademik të angazhuar në programin e studimit “Master i Shkencave në Farmaci” është 10 meshkuj dhe 24 femra, pra 29.4% meshkuj dhe 70.6% femra. Një pasqyrë më e hollësishme jepet në tabelën më poshtë

Personeli akademik	PAE	PAK
Meshkuj	4	6
Femra	10	14
Raporti	28.5% vs 71.5%	30% vs 70%

- Të dhëna sipas moshës së personelit Tabelat në Aneks)

Përsa i përket moshës së personelit akademik, bazuar në të dhënat e RVB Tabela 5 se 10 nga 14 PAE janë nën moshën 45 vjeç, 6 prej të cilëve me gradën Dr. Kjo gjë krijon besim në vazhdimësinë e ofrimit të Programit të studimit “Master i Shkencave në Farmaci”, por njëkohësisht GVJ sygjeron se Institucioni duhet të mbështesë stafin në kualifikime të mëtejshme pasi personeli Profesor janë në moshat mbi 60 vjeç.

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Bazuar në RVB si dhe nga konstatimet e kryera gjatë vizitës në institucion personeli akademik (PAE, dhe PAK) si dhe personeli administrativ, janë të pajisur me kontrata pune që ruhen në zyrën e burimeve njerëzore. Kontratat e punës janë të bazuara në kodin e punës dhe legjislacionin në fuqi. Ato kanë të përshkruar detyrimet dhe të drejtat e secilës palë që nënshkruan. Kontratat e PAE dhe PAK janë të përbëra nga pjesa e përgjithshme dhe ankeset ku specifikohet lënda dhe ngarkesa përkatëse për vitin akademik që nënshkruhet. Staf i administrativ ka kontratë të vecantë.



- Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Bazuar në RVB dhe tabelat që e shoqërojnë rezultojnë se në vitin akademik 2017-2018 ka patur vetëm 2 personel ndihmës-akademik, ndërkohë që në vitin 2018-2019 janë 4 personel ndihmës-akademik.

Nga vizita në institucion GVJ vëren se stafi ndihmës/ administrativ i Departamentit të Farmacisë ishte vetëm 1. Si stafi ndihmës akademik dhe stafi administrativ ishin shumë të angazhuar në kryerjen e detyrave të tyre, qoftë në mbështetje të mësimdhënies, qoftë në detyrat për mbështetjen e institucionit në përgjithësi.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	



Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;

Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.

Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion, u konstatua se në vitin akademik 2018-2019 janë bërë ndryshime në përbërjen e stafit të brendshëm të Departamentit, janë larguar 5 pedagogë dhe janë rritur PAK nga 16 në 19. Kjo ka sjellë një rishpërndarje të ngarkesës mësimore.

Nuk vihet re një normë e caktuar ngarkese për stafin akademik me kohë të plotë pasi ka staf, të cilët mbulojnë rreth **≥ 400 orë mësimore** dhe ka staf që mbulon rreth **30-100 orë** duke mos zbatuar raportin gradë/titull kundrejt ngarkesës mësimore.

Gjithashtu vihet re që ngarkesa e të njëjtës lëndë shpërndahet në disa pedagogë me profile të ndryshme midis tyre. Gjithashtu ka raste kur i njëjti pedagog ka ngarkesë mësimore në lëndë të ndryshme si p.sh:

- **E. B.** realizon ngarkesë mësimore në “Kontroll barnash”, “Kimi Farmaceutike II”, “Kimi Farmaceutike III” dhe “Praktikë profesionale” (**4 module**) në një total prej **634 orësh**. Në bazë të **Urdhrit MASR Nr 29 dt 10.09.2018** kjo pedagoge duhet të bëjë 195 orë plus 200 orë mbingarkesë, pra maksimumi 395 orë.

-**R. Sh.** realizon ngarkesë mësimore në “Teknologji Farmaceutike II”, “Teknologji Farmaceutike III” “Kimi Farmaceutike III” “Praktikë profesionale” dhe në “Kontroll Barnash” (**5 module**) në total prej **449.5 orësh**. Në bazë të Urdhrit Nr 29 dt 10.09.2018 kjo pedagoge duhet të bëjë 90 orë pasi pasi mbulon edhe një pozicion drejtues plus 200 orë mbingarkesë, pra maksimumi **290 orë**.

-**E. G.** realizon ngarkesë mësimore në “Hyrje në Farmaceutikë”, “Teknologji Farmaceutike I”, “Teknologji Farmaceutike II”, “Teknologji Farmaceutike III”, “Biofarmaci, Farmakokinetikë dhe “Kontroll Barnash” (**7 module**), Për një total prej **504.5 orësh**. Edhe në këtë rast ka një anashkalim të **Urdhrit Nr. 29 dt. 10.09.2018 të MASR**, për më tepër që është edhe drejtuese e një prej njërive bazë.

Kjo dukuri haset edhe në PAE të tjerë, ka raste ku pedagogë janë të angazhuar në më shumë se 2 lëndë vjetore apo 3 module semestrare. GVJ mendon se kjo mbingarkesë e PAE nuk i lë shumë hapësira për angazhimin e tyre në kërkim shkencor.

Personeli ndihmës-akademik dhe administrativ megjithëse i pakët në numër ishin të përgjegjshëm për detyrat e caktuara si dhe mirëmenaxhonin materialet didaktike dhe infrastrukturën përkatëse.

Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.

Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;

Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në

Personeli akademik në përputhje me statutin dhe rregulloren është hallka e parë e propozimit të hartimit, ndryshimeve apo edhe riorganizimit të programit të studimit. Në programin e studimit Master i Shkencave në “Farmaci” në kuadër të rekomandimeve të lëna nga akreditimi i parë anëtarët e departamentit kanë propozuar ndryshimet

<p>përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>përkatëse në Asamblenë e Personelit Akademik dhe Zyrën e kurrikulave për mendim.</p> <p>Nga Procedura përkatëse e paraqitur nga IAL rezulton se propozimi dhe shqyrtimi janë bërë në përputhje me statutin dhe rregulloret e njësive kryesore.</p> <p>Edhe miratimi i ndryshimeve në lidhje me planet mësimore dhe programin është bërë në përputhje me aktet normative të institucionit, duke u miratuar nga Senati, kompetencë që përshkruhet në statut dhe rregulloren e Fakultetit Shkencave Mjekësore.</p> <p>Rekrutimi i personelit akademik rezulton të jetë në përputhje me gradën/titullin e përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion u deklarua se përcaktimi i ngarkesës mësimore të PAE dhe PAK është bërë sipas Udhëzimit i MASR Nr. 29 dt. 10/09/2018, por ka disa raste kur nuk përputhet me gradën/ titullin.</p> <p>Lidhur me këtë pikë nga dokumentacioni i dorëzuar, por edhe nga takimi me stafin akademik rezulton se: <i>shpërndarja, megjithë përmirësimet e bëra, zbaton kryesisht udhëzimin e sipërcituar, por nuk merr gjithmonë parasysh gradat, titujt dhe pozicionin përkatës, dhe ata bëjnë edhe më shumë ngarkesë nga sa parashikon Udhëzimi i sipërcituar. (referuar ngarkesës mësimore 2018-2019).</i></p> <p>Ngarkesa mësimore përcaktohet si aneks në kontratën individuale të punës.</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019 insitucioni ka paraqitur edhe listën e personelit akademik efektiv që merr pjesë në ofrimin e programit të studimit Master i Shkencave “Farmaci” ku përfshihen edhe 15 PAE (14 sem II), 7 të Departamentit të Farmacisë dhe 8 nga Departamentet e tjera të F.SH.M., UAL, nga të cilët 1 Prof. Dr., 2 Prof. As., 7 Dr. (6 sem II) dhe 5 Msc.</p>
<p>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Bazuar në RVB, aktet bashkangjitur si dhe Vizita në IAL e takimi me personelin akademik apo Personelin e Burimeve Njerëzore rekrutimi i personelit për vitin akademik 2018-2019 realizohet si vijon:</p> <p>fillimisht shpallen vendet vakante nga departamenti dhe nevojat e njësisë bazë i bëhen të ditura në mënyrë shkresore Dekanit, i cili i përcjell në Senatin Akademik, i cili më pas përcakton kriteret, procedurat dhe Komisionin e Vlerësimit.</p> <p>Pas dorëzimit të dosjeve të aplikantëve Komisioni i Vlerësimit shpall fituesit.</p> <p>Në dokumentacionin e deklaruar nga IAL, Njësia Bazë propozon për çdo lëndë vendet vakante duke specifikuar vetë kriteret.</p> <p>Personeli Akademik me Kohë të plotë i angazhuar në këtë program studimi për vitin akademik 2018-2019 përbën:</p> <p>14/34 të personelit akademik në departament, pra 41.17% si program studimi.</p>

	<p>Institucioni kryen proces vlerësimi të performancës, kryesisht nëpërmjet pyetësorëve të studentëve, formularit të vetëdeklarimit të pedagogëve, vlerësimi nga departamenti, të cilat së bashku shërbejnë për të plotësuar formularin e performancës individuale.</p> <p>Performanca diskutohet në përgjithësi në mbledhjet e departamentit. Në takimin me stafin pati përgjigje të ndryshme.</p> <p>Institucioni zotëronte një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, si dhe të njoftimeve për vende vakante.</p>
<p>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</p>	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p>	<p>Përgjegjësi i programit të studimit ka gradën “Doktor”. Titullarët e lëndëve janë kryesisht me titull Prof. As. dhe Prof.Dr.</p> <p>Sipas RVB në programin e studimit për vitin akademik 2018-2019 vihet re se:</p>
<p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p>	<p>- <i>Përsa i përket gradës së titullarëve ajo plotësohet tek të gjitha, por i njëjti pedagog është titullar në më shumë se 2 lëndë.</i></p> <p>- <i>Të gjitha syllabuset janë firmosur nga titullari, ndërkohë që Lektori i Lëndës është dikush tjetër.</i></p>
<p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p>	<p><i>Të gjitha syllabuset ishin të firmosura nga titullari dhe pedagogu i lëndës si dhe nga Përgjegjësi i Departamentit. Megjithatë vlen të theksohet se në më shumë se një rast syllabusi ka të parashikuara seanca laboratorike ose praktika, por tematikat e tyre mungojnë, ndërkohë që në fund të syllabus-it kërkohet që të shlyhen 100%.</i></p> <p>Autoritetet drejtuese siç janë Rektori, Dekani, Drejtuesi i Departamentit janë të punësuar me kohë të plotë pranë universitetit në përputhje me aktet ligjore në fuqi.</p>
<p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p>	<p>Bazuar në RVB dhe nga konstatimet gjatë vizitës në institucion Përgjegjësi i programit të studimit mban gradën shkencore “Doktor i Shkencave” dhe në aneks kontratë ka të përcaktuar përgjegjësitë e punë.</p> <p><i>Në këtë kuadër GVJ sygjeron që t’i jepet më pak ngarkesë mësimore në përputhje me udhëzimet e normat ligjore.</i></p>
<p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Praktikat profesionale kryhen në përputhje me rregulloren e programit të studimit dhe me marrëveshje me subjekte farmaceutike private. Studenti kualifikohet për të kryer praktikën profesionale vetëm pasi ka fituar të gjitha kreditet. Studenti mban ditarin përkatës, i cili firmoset nga drejtuesi i praktikës dhe nga Drejtuesi i Departamentit. <i>GVJ sygjeron që duhet bërë një ndarje më e njëtrajtshme e ngarkesës për mbikëqyrjen e Praktikës profesionale që të mos rezultojë që 1 pedagog i vetëm të marrë 470 orë ngarkesë të tillë.</i></p>
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	

<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Në RVB thuhet se në vitin akademik 2015-2016 të gjithë studentët janë diplomuar me temë diplome në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”.</p> <p>Në dokumentacionin e dorëzuar gjatë vizitës në institucion, lista e studentëve me temat përkatëse të diplomës përbëhet nga 41 studentë.</p> <p>Në listën e dorëzuar udhëheqësit e temave të diplomës për vitin akademik 2015-2016 rezultojnë me gradën Dr., Prof. As., ose Prof.Dr.</p> <p>Në përgjithësi Drejtuesit e temave të diplomës (PAE, PAK) kanë në udhëheqje jo më se shumë 5 studentë kandidatë për diplomim, <i>përveç një pedagogu që ka 6 studentë në udhëheqje.</i> Në këtë rast na u sqarua nga GVB se ishte një student i mbartur.</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Bazuar në listën e dorëzuar nga insitucioni të temave të diplomës të kryera dhe udhëheqësve shkencorë përkatës, GVJ vëren se në përgjithësi përputhen me fushat e ekspertizës përkatëse të temës .</p> <p>Pra ekspertiza e tyre është e thelluar dhe në përputhje me temën që kanë marrë në udhëheqje.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Ndryshe nga sa deklarohet në RVB dhe dokumentet shoqëruese, gjatë vizitës në institucion u vu re se Departamenti i Farmacisë kishte një numër të pamjaftueshëm personeli ndihmës-akademik-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe mirëmbajtjen e tyre, vetëm 1 të tillë për 4 laboratorë.</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Stafi akademik e ka ngarkesën në përputhje me planin mësimor, por vërehet një mbingarkesë sidomos edhe e stafit që mbulon edhe detyra të tjera administrative.</p> <p>GVJ vëren se nuk merren parasysh grada/titulli për përcaktimin e orëve mësimore siç rekomandohet në udhëzimin e sipërcituar. Shpërndarja është e çrregullt.</p> <p>Ngarkesa mësimore i shtohet kontratës së punës si aneks kontratë.</p>
<p>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion, IAL – ja ka një bazë të dhënash të hollësishme të mirëorganizuara për personelin akademik, e cila gjendet pranë zyrës së Burimeve Njerëzore. Kjo zyrë disponon për secilin semestër stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi në formën e vendimeve ekzekutive dhe informuese nga Dekani përkatës.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion u kërkuan CV e personelit akademik dhe u sollën nga UAL-ja përmes sistemit AMS pranë ASCAL. Gjatë shqyrtimit të tyre u vu re se ato kishin disa parregullsi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Disa ishin të papërditësuara si për PAE ashtu edhe për PAK 2- disa ishin shqip e disa anglisht, në formate të ndryshme 3- disa ishin të mangëta në informacion dhe nuk kuptohej se kur e në çfarë drejtimi pedagogu kishte kryer studimet doktorale <p><i>GVJ sygjeron përditësimin e dokumentacionit të stafit akademik të këtij programi studimi.</i></p> <p>Institucioni përcakton kriteret, ku sipas statutit i miraton Senati Akademik në bazë të propozimeve të njësisë bazë.</p>
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Bazuar në RVB dhe në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në institucion GVJ vlerëson se, në vitin 2018-2019 është arritur që mbi 70% e ngarkesës të kryhet nga PAE. PA përbëhet nga 4 persona, të përkushtuar e me eksperiencë të mjaftueshme pune për të kryer funksionet e tyre. Gjithësesi raporti PA/student rezulton 1/70 dhe aq më tepër, *vetëm 1 Personel ndihmës akademik për gjithë laboratorët e programit të studimit.*
2. Për sa i përket shpërndarjes së ngarkesës është bërë një punë e mirë gjatë këtij viti për të arritur qëllimin që mbi 2/3 e saj të realizohet nga stafi me kohë të plotë, por kjo ka çuar në mbingarkesë të 8 nga 14 PAE si dhe në realizimin e kësaj ngarkese në më shumë se 3 lëndë. *Nuk vihet re një normë e caktuar ngarkesë për stafin akademik me kohë të plotë pasi ka staf, të cilët mbulojnë rreth 395-426 orë mësimore dhe ka staf që mbulon rreth 30-100 orë, duke mos zbatuar raportin gradë/titull kundrejt ngarkesës mësimore.*
3. Të gjitha Syllabuset e lëndëve për vitin akademik 2018-2019 janë firmosur nga titullari i lëndës, *Shpesh gjejmë të njëjtin titullar në 3-4 lëndë të ndryshme. Ka raste që CV-ja e Titullarit nuk përputhet me të gjitha lëndët ku ai ka firmosur.*
4. Në lidhje me rekrutimin e stafit akademik me kohë të plotë nga gjetjet gjatë vizitës në institucion u vu re se bëhej me transparencë bazuar në kriteret të përcaktuara nga njësia bazë dhe përdorej një tabelë pikëzimi me 100 pikë në total. *GVJ sygjeron përditësimin e dokumentacionit të stafit akademik të këtij programi studimi.*
5. Në udhëheqjen e diplomave GVJ mendon se Departamenti i Farmacisë dhe F.SH.M. kanë bërë një punë të mirë në lidhje me përshtatjen e fushës së ekspertizës së pedagogut me temën përkatëse të diplomës.

4. **Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

Pjesa përshkimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Në RVB GVJ mendon se janë paraqitur të gjitha ambjentet e Universitetit "Aldent" dhe jo vetëm ato që shfrytëzohen për programin e studimit Master i Shkencave në "Farmaci".

Gjatë vizitës në institucion u konstatua se ndërtesa në funksion të programit të studimit "Master i Shkencave" në "Farmaci" është Kati i 9 dhe kati i 10 në Godinën në Rr. Dibrës, ku gjendet edhe administrata dhe zyrat e autoriteteve drejtuese të institucionit. Programet e tjera janë zhvendosur në Godinën pranë Casa Italia. Të dyja godinat janë me qera. Ndërkohë u deklarua se në periferi të Tiranës po ngrihet Kampusi i Ri Universitar që së shpejti do të bëhet funksional.

Godina aktuale është në qendër të Tiranës dhe në të gjenden 4 salla mësimore me kapacitet 30-90 studentë të pajisur me videoprojektorë dhe tabela, 4 laboratorë të pajisura me aparaturat e nevojshme për zhvillimin e seancave laboratorike të lëndëve profesionale dhe atyre të përgjithshme me karakter kimik. Vihet re se në këtë godinë nuk ka laboratorë për lëndët mjekësore si p.sh.: Anatomi, Mikrobiologjisë, etj, të cilat në bazë të dokumentacionit janë të vendosura në Godinën në Kashar.

Po në këtë godinë ka ambjente komode për personelin akademik dhe administrativ, me sistem ngrohje-ftohje dhe një sistem të sigurimit pa ndërprerje të energjisë elektrike.

Pjesë e rëndësishme e infrastrukturës është dhe biblioteka e Fakultetit të Shkencave Mjekësore.

Pjesë e bibliotekës është dhe literatura bazë dhe e këshilluar e programit të studimit. Literatura është kryesisht e pajisur me botime të 10 viteve të fundit.

Gjithashtu vlen të përmendet se infrastruktura ka në përbërje të saj edhe ambjentet e shërbimit si bar-kafe, fast-food me çmime të redukturara.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit (**Tabela 16**)

- Salla për leksione – 2
- Klasa për seminare – 2
- Laboratorë për lëndët- 4
- Laboratorë informatike -0
- Salla interneti -1
- Salla për bibliotekë -1
- Mjedis për fotokopjime, librari etj- 1
- Zyrë informacioni për studentët -1
- Nyje hidrosanitare -4

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/zv.dekanin/kancelarin -3
- Zyra për sekretarinë mësimore -1
- Zyra për departamentet-2
- Zyra për qëndrat kërkimore -1
- Zyra për personelin akademik -4
- Zyre e Burimeve Njerezore -1

Shënim: Gjithësesi nga një llogaritje e GVJ rezultojnë se për programin e studimit Master i Shkencave "Farmaci" sipërfaqja shkon në 2310 m² dhe rezultojnë 8.25m²/student.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;	Institucioni ka vendodhje të qëndrueshme në më shumë 6 vjet në një zonë shumë afër qendrës së Tiranës. Gjatë vizitës së GVJ u konfirmua se po ndërtohet një kampus i ri i cili do të sjellë rritje në cilësi të standardeve të infrastrukturës. Ndërtesa në funksion të programit të studimit Master i Shkencave në "Farmaci" është Kati i 9 dhe kati i 10 në Godinën në Rr. Dibrës, ku gjendet edhe administrata dhe zyrat e autoriteteve drejtuese të institucionit. Kjo njësi ofron një sipërfaqe totale rreth 2310 m ² . Më parë ambjentet kanë qenë më të vogla, por me largimin e programeve të tjera të studimit në godinën afër Casa Italia, ambjentet e programit të studimit në fjalë u shtuan. Kjo tregon se institucioni përpigjet të menaxhojë në mënyre efikase zbatimin e politikave dhe standardeve të cilësisë. Edhe fakti i ndërtimit të kampusit të ri është një tregues i objektivit të institucionit për të rritur gjithnjë e më shumë cilësinë e procesit mësimor dhe të jetës studentore. Institucioni në kuadër të marrëveshjeve me subjekte farmaceutike ka krijuar infrastrukturën e duhur për realizimin e praktikave profesionale.
Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;	
Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;	
Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;	Pjesë rëndësishme e infrastrukturës është dhe biblioteka e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, e cila ofron literaturë bazë dhe ndihmëse me një total prej 5000 tekste për të gjithë IAL. (referuar RVB). Gjatë vizitës në institucion u deklarua se tekste për programin e studimit Master i Shkencave në "Farmaci" janë të pakta, por studentët mund të shfrytëzojnë edhe shërbimin e internetit për qëllime studimi. Pjesë e bibliotekës është dhe literatura bazë dhe e këshilluar e programit të studimit, e cila është kryesisht e botimeve të 10 viteve të fundit. <i>GVJ vëren se nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës në</i>
Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;	
Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të	

<p>programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p><i>institucion nuk konstatua ndonjë plan institucional për shtimin e zërave të bibliotekës. Ky proces zhvillohej me propozim të ndonjërit prej pedagogëve dhe nuk kishte një procedurë periodike për shtimin e fondit për farmacinë.</i></p> <p>Biblioteka funksiononte në oraret të përshtatshme dhe paralel me oraret e mësimit.</p>
--	---

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup lëksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>Programi i Studimit Master i Shkencave në “Farmaci” ka në dispozicion</p> <ul style="list-style-type: none"> - Salla lekionesh, seminaresh - Zyra për stafin akademik dhe administrativ <p>të cilat përmbushin kushtet dhe kriteret cilësore për realizimin e procesit mësimor.</p> <p>-Laboratorët janë pjesë e rëndësishme e infrastrukturës që shërben për përmbushjen me sukses të programit mësimor dhe zhvillimin e kërkimit shkencor. Ato janë pozicionuar në katin e 10 të godinës. Gjatë vizitës u vu re se ato janë ndërtuar në përputhje me plan-programin e lëndëve kryesisht me karakter kimiko-farmaceutik dhe plotësojnë kërkesat e programeve përkatëse.</p> <p>Laboratorët janë të pajisur me mjete dhe reagentë në mënyrë të përshtatshme me objektivat dhe qëllimet e programit të studimit.</p> <p>Laboratorët që konstatuam gjatë vizitës në IAL janë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Laboratori 10.1 i Kimisë Analitike, Kimisë së Përgjithshme dhe Inorganike, Kimisë Organike • Laboratori 10.2 i Botanikës farmaceutike, Farmakognozisë • Laboratori 10.3 i Kimisë FarmaceutikeII, Kimisë farmaceutike III, Kontroll Barnash, Toksikologji analitike • Laboratori 10.4 i Teknologjisë Farmaceutike II, Teknologji Farmaceutike III. <p>Në RVB thuhet se ky laborator shërben edhe për lëndën <i>Metodat Instrumentale të Analizës</i> që nuk bën pjesë në plan-programin mësimor të farmacisë. Nga ana tjetër lënda Farmaci fizike që është pjesë e programit mësimor nuk përmendet fare.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nuk kishte asnjë preparator. <p>Është pozitive pajisja e laboratorit të kontrollit të barnave me pajisje të tilla si spektrofotometër UV-VIS dhe HPLC të firmës prestigjioze Agilent, por nga ana tjetër ka vetëm nga një peshore analitike në laboratorin e Kimive, ku siç na u deklarua gjatë vizitës secili student bënte punë individuale, gjë që e bën të vështirë realizimin e punës laboratorike brenda kohës së caktuar. Megjithatë bazuar në RVB këta laboratorë kanë edhe një sërë peshorësh teknike për realizimin me sukses të punëve laboratorike.</p> <p>Këto aparatura shërbenin si për procesin didaktik, edhe atë të kryerjes së punëve eksperimentale për diplomat e studentëve apo kërkimin shkencor.</p>
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni ka vendodhje të qëndrueshme në më shumë 6 vjet në një zonë shumë afër qendrës së Tiranës. Gjatë vizitës së GVJ u konfirmua se po ndërtohet një kampus i ri, i cili do të sjellë rritje në cilësi të standardeve të infrastrukturës. Ndërtesa në funksion të programit të studimit Master i Shkencave në “Farmaci” është Kati i 9 dhe kati i 10 në Godinën në Rr. Dibrës, ku gjenden edhe zyrat e administratës dhe zyrat e autoriteteve drejtuese të institucionit.
2. Pjesë rëndësishme e infrastrukturës është dhe biblioteka e Fakultetit të Shkencave Mjekësore e cila ofron literaturë bazë dhe të këshilluar të programit të studimit, e cila është kryesisht e botimeve të 10 viteve të fundit. Gjatë vizitës në institucion u deklarua se tekstet për programin e studimit Master i Shkencave në “Farmaci” janë të pakta, por studentët mund të shfrytëzojnë edhe shërbimin e internetit për qëllime studimi. *Nuk konstatoam ndonjë plan institucional për shtimin e zërave të bibliotekës. Ky proces zhvillohej me propozim të ndonjërit prej pedagogëve dhe nuk kishte një procedurë periodike për shtimin e fondit për farmacinë.*
3. Laboratorët janë ndërtuar në përputhje me plan-programin e lëndëve kryesisht me karakter kimiko-farmaceutik dhe plotësojnë kërkesat e programeve përkatëse. Laboratorët janë të pajisur me mjete dhe reagentë në mënyrë të përshtatshme me objektivat dhe qëllimet e programit të studimit. Duhet përmendur fakti që laboratorët për lëndët me karakter mjekësor janë të lokalizuar në godinën në Kashar.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Burimi i vetëm i të ardhurave të Universitetit “Aldent” janë tarifat e shkollimit. Institucioni ka një raport financiar për çdo vit buxhetor të hartuar dhe certifikuar si nëpërmjet auditimit të brendshëm edhe atij të jashtëm. Nga të dhënat vihet re se të ardhurat kanë ardhur në rritje, por gjithashtu edhe kosto/student ka ardhur në rritje dhe mbështetja vetëm në të ardhura nga tarifat e shkollimit mund të përbëjë risk financiar në rast të rënies së numrit të të regjistruarve.

Shpenzimet kanë të bëjnë kryesisht me pagat, sigurimet shëndetësore e shoqërore, aktivitete shkencore, qira, ngrohje, ftohje etj dhe vihet re se nga viti 2014-2018 edhe ky zë ka ardhur në rritje.

Bazuar në RVB vendin kryesor të kostove e zënë shpenzimet dhe pagat, më pas vjen kosto për student dhe së fundi investimet. Investimet janë rritur nga 2014-2017, ndërsa për 2018 janë ulur. Bazuar në DVV nuk janë dhënë opsione për shtimin e burimeve të tjera financiare gjë që u konstatua edhe gjatë vizitës ku përfaqësuesit e stafit të QKF mendonin se ky institucion nuk kishte nevojë për të ardhura shtesë.

GVJ sugjeron se duhen rritur kapacitetet menaxhuese për të ulur kostot administrative dhe rritur buxhetin për kërkimin shkencor.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të ardhurat në këtë program studimi janë 100 % nga tarifat për shkollimin pasi gjatë shkollimit siç u konstatua edhe gjatë vizitës në institucion studentët nuk paguajnë asgjë tjetër.
- Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Bazuar në DVV GVJ vëren se shpenzimet për studentë dhe kostot për student për vitin akademik 2018-2019 janë 41.45% e të ardhurave që mblidhen nga tarifat e shkollimit të studentëve. Shihet se zëri i shpenzimeve për kërkimin shkencor nuk përmendet apo me saktë nuk shprehet si zë më vete, 54.4% e të ardhurave shkojnë për zërin e shpenzimeve, 20% paga dhe 18% investime.

Nga gjendja e konstatuar gjatë vizitës në institucion GVJ sugjeron se do ishte me vend të ofroreshin shërbime për të tretë nga QKF me qëllim shtimin e burimeve të të ardhurave për programin e studimit "Master i Shkencave" në "Farmaci". Në të njëjtën kohë do krijohet edhe mundësia për rritjen e buxhetit për kërkimin shkencor.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Burimi i vetëm i të ardhurave të Universitetit "Aldent" janë tarifat e shkollimit. Institucioni ka një raport financiar për çdo vit buxhetor të hartuar dhe çertifikuar si nëpërmjet auditimit të brendshëm edhe atij të jashtëm. Nga të dhënat vihet re se të ardhurat kanë ardhur në rritje, por gjithashtu edhe kosto/student ka ardhur në rritje dhe mbështetja vetëm në të ardhura nga tarifat e shkollimit mund të përbëjë risk financiar në rast të rënies së numrit të të regjistruarve.</p> <p>Bazuar në DVV për vitin akademik 2018-2019 të ardhurat nga tarifat e studimit janë 476,556.000 kundrejt 444.306,771 që ishin në 2017-2018. (Tabela 8 RVB). Gjithashtu rezultojnë se një pjesë e rëndësishme e të të ardhurave shkojnë për paga e shpenzime gjë që rrit koston për student.</p> <p><i>Bazuar në DVV, bazuar në të dhënat gjatë vizitës institucioni megjithëse ka një Qendër Kërkimore Farmakoterapeutike nuk ka kryer asnjë shërbim për të tretë. GVJ sugjeron se institucioni duhet të shfrytëzojë të gjitha burimet e mundshme financiare për të patur një situatë financiare solide pavarësisht numrit të studentëve.</i></p>
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	

Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.

Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.

Institucioni referuar raportit financiar të deklaruar dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare si në aspektin e gjenerimit e të ardhurave, por edhe në mirëmenaxhimin e kostove operative.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni harton një raport financiar për çdo vit buxhetor të audituar nga ekspertë të brendshëm e të jashtëm me zëra të veçantë në përputhje me aktet ligjore tatimore në fuqi.
2. Burimi i vetëm i të ardhurave është nga tarifa e shkollimit gjë që mund të përbëjë risk financiar në rast të uljes së numrit të studentëve .
3. Institucioni referuar analizës financiare të paraqitur tregon stabilitet financiar, si dhe dëshmon se ka kapacitet për të gjeneruar të ardhura nga burime të tjera, duke zhdërvjelltësuar procedurat dhe duke ofruar shërbime për të tretë, sidomos nëpërmjet Qendrës Kërkimore Farmakoterapeutike.

Institucioni duhet të hartojë plan masa për të rritur të ardhurat nga burime të tjera përveç tarifës së shkollimit sic janë grantet apo projektet.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Universiteti “Aldent” në zbatim për Ligjit 80/2015 të Arsimit Të Lartë dhe Kërkimin Shkencor ka hartuar statutin e ri dhe organizuar Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë me 5 anëtarë, 3 të brendshëm dhe 1 ekspert i jashtëm, 1 anëtar nga radhët e studentëve Bazuar në DVV, NJBSC ka një procedurë të funksionimit të saj që bazohet ende në Ligjin 9741 dt 12.11.2017 Neni 59 çka bie ndesh me sa më sipër. Kjo Njësi funksionon në zbatim të Rregullores përkatëse të miratuar me Vendim të Senatit Akademik i UAL Nr.45 Dt.7. 11.2018 (akti 7 dokumentacioni shtesë). Kjo njësi realizon një aktivitet të programuar, në bashkëpunim me të gjithë departamentet, trupën mësimore dhe studentët. Aktiviteti realizohet periodikisht dhe në forma të larmishme të kontrollit të cilësisë së mësimdhënies me anketime vjetore semestrale, me fokus grupe në mënyrë elektronike duke u kujdesur gjithnjë për të siguruar anonimatën e pjesëmarrësve. E gjithë kjo veprimtari zhvillohet me synimin final për të arritur në një vlerësim sa më korrekt. Përpunimet statistikore dhe të dhënat e përfuara diskutohen sipas shkallës hierarkike dhe i dërgohen si Rektorit të UAL, po ashtu edhe NJBSC. Kjo e fundit e dërgon “Raport Vlerësues” final në Senat. Të dhënat e përfuara në raportet e vërejtura tregojnë për një cilësi

mësimdhënie të mirë, shprehur kjo gjatë vitit të kaluar shkollor (raporte semestrale dhe vjetore). U vërejt nga GVJ se mënyra elektronike e vlerësimit ishte funksionale aktualisht dhe studentët mund të shpreheshin lidhur me procesin e mësimdhënies cilësisë së tyre, pedagogëve respektivë, pëlqyeshmërisë së zhvillimit të mësimit etj, nëpërmjet një pyetsori shumë të gjerë, por edhe që realizonte qëllimin e kontrollit të cilësisë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

- Sa anketime kanë bërë me studentët 2/vit akademik
- Sa studentë janë anketuar 123 rreth 30-37 %(2017-2018)
- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë

Gjatë 5 viteve nga 2013-2017 janë bërë përpunuar 5 anketime dhe të gjithë të dhënat e mbledhura nga pyetsorët janë përpunuar. Nga analiza e tyre ka rezultuar se në përgjithësi studentët janë shprehur pozitivisht. Studentët kanë ngritur problematika të tilla si Lëndë të vështira, nevojë për këshillim shtesë, nuk mjafton informacioni brenda klasës pasi shpesh nuk arrijnë të informohen të gjithë, sistemi elektronik i sekretarisë si dhe nevoja për mësim interaktiv.

- Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm

Rezultatet e përfuara nga të dhënat e pyetësorëve kalohen për analizë në Departament, përpilohet një Raport semestral dhe vjetor i anketimeve dhe rezultateve. Janë marrë masa në bashkëpunim me titullarët e lëndëve për përmirësimin e metodave të mësimdhënies, aplikimin e sistemit të tutoratit, është instaluar sistemi online i sekretarisë mësimore etj.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Kontrolli i brendshëm i cilësisë, realizohet nga NJBSC e strukturuar me personel bashkëpunues me të gjitha strukturat e tjera të mësimdhënies deri në nivel departamenti. Aktiviteti i NJBSC mbështetet në Statutin e IAL dhe në rregulloren përkatëse, duke hartuar dhe politika të sakta të kontrollit të cilësisë. Kjo njësi varet direkt nga Rektori dhe raporton çdo vit për veprimtarinë e kryer në Senatin Akademik.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

NJBSC është përgjegjëse e kontrollit të cilësisë së mësimdhënies. Çdo anëtar vjetor i saj përfaqëson një njësi kryesore dhe merr të dhënapër këtë njësi që i përcjell në mbledhjet eriodike të Njësisë SBC.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Gjatë vitit akademik 2018-2019 është realizuar 1 anketim semestrin parë, ku janë përfshirë 163 studentë të FSHM 32.6% vecanërisht për farmacinë kanë marrë pjesë 97 studentë pra 19.72% të studentëve të programit Msc. Farmaci dhe përgjithësisht rezultatet e anketimeve tregojnë për përgjigje pozitive të mësimdhënies etj. Disa nga problematikat e ngritura ka qenë kapaciteti i vogël i ashensorëve si dhe pakënaqësi në lidhje me vlerësimin.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Vlerësimet e kryera nga NJBSC janë një aktivitet konkret dhe përgjithësues për rritjen e cilësisë si nga forma dhe përmbajtja. Përveç pyetësorëve NJBSC organizon edhe monitorime direkte të vlerësimit të studentëve dhe ka rezultuar se procedurat e ndjekura kanë qenë korrekte. Përpos kësaj studenti ka të drejtën e ankimit dhe rivlerësimit edhe nga një komision tjetër.

GVJ sugjeron rritjen e numrit të pjesëmarrësve përsa i përket pyetësorëve me ta.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në Institucion u mor edhe raporti më i fundit i NJBSC së UAL.

“Raport mbi Rezultatet e pyetësorit të studentëve të UAL për vitin akademik 2018-2019” hartuar në Mars 2019.

Ky është një Raport në nivel Institucional. Në të kanë marrë pjesë 97 studentë të programit të studimit Master i Shkencave “Farmaci”, pra vetëm 19.7%. Rezultatet e anketimeve tregojnë për përgjigje pozitive të mësimdhënies etj. Disa nga problematikat e ngritura ka qenë kapaciteti i vogël i ashensorëve si dhe pakënaqësi në lidhje me vlerësimin.

Në lidhje me problematikat e ngritura NJBSC organizon edhe monitorime direkte të vlerësimit të studentëve dhe ka rezultuar se procedurat e ndjekura kanë qenë korrekte. Përpos kësaj studenti ka të drejtën e ankimit dhe rivlerësimit edhe nga një komision tjetër.

Vlerësimi sipas Standardeve



Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;	Pas shqyrtimit të DVV dhe takimit me përfaqësuesit e NJBSC gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se Universiteti “Aldent” ka organizuar Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë me 5 anëtarë, 3 të brendshëm dhe 1 ekspert i jashtëm, 1 anëtar nga radhët e studentëve Kjo Njësi funksionon në zbatim të Rregullores përkatëse të miratuar me Vendim të Senatit Akademik i UAL Nr.45 Dt.7.11.2018 (akti 7 dokumentacioni shtesë). Bazuar në DVV, NJBSC ka një procedurë të funksionimit të saj që bazohet ende në Ligjin 9741 dt 12.11.2017 Neni 59 çka bie ndesh me sa më sipër. Kjo njësi realizon një aktivitet të programuar, në bashkëpunim me të gjithë departamentet, trupën mësimore dhe studentët. Aktiviteti realizohet periodikisht dhe në formë të larmishme të kontrollit të cilësisë së mësimdhënies me anketime vjetore semestrale, me fokus grupe në mënyrë
Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;	
Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;	
Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.	
<u>Të tërthorta:</u> a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;	

<p>b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</p> <p>c. Pyetje konceptuale;</p> <p>d. Intervista;</p> <p>e. Etj.</p> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <p>a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj.);</p> <p>b. Dëgjime në auditor;</p> <p>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</p> <p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	<p>elektronike duke u kujdesur gjithnjë për të siguruar anonimatën e pjesëmarrësve. E gjithë kjo veprimtari zhvillohet me synimin final për të arritur në një vlerësim sa më korrekt. Përpunimet statistikore dhe të dhënat e përfuara diskutohen sipas shkallës hierarkike dhe i dërgohen si Rektorit të UAL, po ashtu edhe NJBSC. Kjo e fundit e dërgon “Raport Vlerësues” final në Senat. NJBSC përdor metodologji të tërthortë dhe të drejtpërdrejtë për vlerësimin e cilësisë, nëpërmjet anketimeve elektronike (2 herë në vit), fokus grupeve (1 herë në vit), si dhe vlerësimeve konkrete të zhvillimit të praktikave dhe laboratorëve apo vlerësimit të studentëve.</p> <p>NJBSC përfundimin e rezultateve e ka praktikë pune diskutimin me njësinë bazë dhe miratimin e Raportit në Senat.</p> <p>Publikimi i raportit të kontrollit të cilësisë në ëbsite-in e IAL, mendojmë se është një praktikë shumë efektive ku të dhënat bëhen të njohura për studentët, pedagogët dhe më gjerë.</p> <p>Nga Raporti i fundit Mars 2019 i NJBSC, që GVJ disponon rezulton se disa nga problematikat më të ndjeshme për studentët ka qenë kapaciteti i vogël i ashensorëve si dhe pakënaqësi në lidhje me vlerësimin.</p> <p>Në lidhje me problematikat e ngritura NJBSC organizon edhe monitorime direkte të vlerësimit të studentëve dhe ka rezultuar se procedurat e ndjekura kanë qenë korrekte. Përpos kësaj studenti ka të drejtën e ankimit dhe rivlerësimit edhe nga një komision tjetër.</p>
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>NJBSC informacionin përfundimtar e bën publik nëpërmjet ëeb-it të Universitetit “Aldent”, përpos analizës që bëhet në çdo departament.</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>GVJ vëren se NJBSC e ka praktikë pune hartimin dhe dërgimin e një Raporti Vlerësimi” final në Senatën Akademik ku diskutohet dhe merren masat përkatëse në varësi të problematikave të ngritura. Po ashtu diskutohet edhe në nivel Departamenti për të përafuar procesin e mësimdhënies/mësimnxënies me nivelet më të larta të kërkuesve.</p>
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	

<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>UAL është i akredituar si institucion me Vendim Nr. 114, Dt. 15.12.2017 çka do të thotë se i përmbush detyrimet ligjore në lidhje me standardet institucionale të cilësisë.</p> <p>Në aktivitetin e tij Universiteti “Aldent” i përmbahet Normave ligjore në fuqi, Rregullores së Institucionit, Statutit Neni 13 “për organizimin e punës për kontrollin e brendshëm”. Në këtë kuadër ka ngritur NJBSC të përbërë nga 5 anëtarë, 1 përfaqësues për çdo njësi kryesore, 1 ekspert i jashtëm dhe 1 përfaqësues i studentëve. Me Vendim Nr. 45 Dt. 7. 11.2018 Senati Akademik ka miratuar Rregulloren e kësaj Njësie. Anëtarët e NJBSC kanë mandat 1 vjeçar.</p> <p>Informimi i studentëve dhe i personelit të UAL mbi Programin e studimit dhe rëndësinë e sigurimit të cilësisë në të kryhet nëpërmjet publikimit të Raportit Vjetor në faqen e ëeb-it të IAL-së, diskutimit të gjetjeve të këtij raporti në Departamente.</p> <p>Strategjia, politika e institucionit për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë konsiston në zhvillimin 2 herë në vit të pyetësorëve, para sezonit të provimeve dhe plotësimin e formularëve të performancës nga personeli. Procedurat janë miratuar në përputhje me Statutin e UAL.</p>
---	---

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Bazuar në RVB dhe takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se nga pikëpamja e sigurimit të cilësisë një rol kyç ka NJBSC. Kjo njësi bën përpjekje serioze për vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative duke kombinuar mënyra të tërthorta dhe të drejtpërdrejta. Zyra prej nëntorit 2018 ka rregulloren saj specifike.
2. Përbërja e NJSBC është në përputhje me Statutin e ri të UAL me 5 anëtarë, 3 anëtarë nga 3 Fakultetet përbërëse të UAL pedagoge me kohë të plotë, 1 ekspert i jashtëm pedagog me kontratë dhe 1 përfaqësues i studentëve, të gjithë me mandat 1 vjeçar. Kjo Njësi ka hartuar edhe një Procedurë të funksionimit të saj, të cilën e mbështet ende në Ligjin 9741 dt 12.11.2017. GVJ sygjeron përditësimin e saj, në zbatim të Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”.
3. Kjo njësi ka praktikë normale hartimin dhe dërgimin e Raportit vjetor pranë Senatit Akademik Më pas ky raport publikohet në ëeb-in e UAL.
4. Një hap shumë i rëndësishëm për rritjen e cilësisë është edhe zhvillimi online i pyetësorëve në anonimat të plotë, por *GVJ sygjeron rritjen e numrit të studentëve që marrin pjesë si dhe zhvillimin e sondazheve anonime edhe tek personeli akademik dhe administrativ për të dëgjuar edhe zërin e tyre.*

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi i studimit Master i Shkencave në "Farmaci" ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Departamenti i Farmacisë. Misioni dhe objektivi i programit të studimit në përgjithësi përputhet me përmbajtjen e programit.


Viti akademik është organizuar në 2 semestra me nga 15 javë, pra 30 javë mësimore në auditor. Studimet zgjatën 5 vjet me një total kreditesh 300 ECTS. Në përfundim të studimeve studenti pajiset me Diplomë "**Master i Shkencave në Farmaci**" miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve me **Urdhër Nr.468 dt. 03.05.2013**, "Për akreditimin e programit të studimit që përfundon me "Master i Shkencave në Farmaci" të Shkollës së Lartë Universitare Jo-Publike "Aldent". (akti 4). Në vendimet e mëpasshme UAL ka ruajtur akreditimin përkatës.

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga IAL vihet re se puna për ndryshimin e kurrikulave është një përpjekje serioze që të gjithë elementët si lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, të përmirësohen konform kriterëve të përcaktuara, përveç disa lëvizjeve të pamotivuara nga pikëpamja e formimit të studentit si p.sh.: spostimi i disa lëndëve të pararendëse në njohuri e disa lëndëve profesionale nga viti i II në vitin e IV, apo ngjeshja e lëndëve profesionale në vitin e III dhe IV duke vënë Praktikën Profesionale në dy semestra në vitin e V.

Literatura e detyruar është në gjuhën shqipe dhe gjendet edhe në bibliotekën e universitetit. Fondi i teksteve në bibliotekë, në sallën në godinën e Rr. Dibrës është 3500 nga të cilat një pjesë e vogël është posaçërisht për studentët e farmacisë, tekste origjinale ose të përkthyer. Ndërkohë që Departamenti i Farmacisë ka bërë një kërkesë për pasurimin e bibliotekës së universitetit me disa tituj, ndër të cilët disa janë shtim kopjesh dhe disa tituj të rinj për këtë program studimi.

Programi i studimit është i ndërtuar me lëndë dhe module përbërëse, Teknologji Farmaceutike II dhe III dhe Kimi Farmaceutike II dhe III, Kontroll barnash dhe Legjislacion Farmaceutik, Biofarmaci dhe Farmakokinetikë duke ndarë kreditet duke bërë të mundur avancimin e studentëve në vitet e mësipërme apo edhe në mobilitetin e tyre.

- Referuar VKM Nr. 41, Dt. 24.01.2018 kriteri parashikon që lëndët e kategorisë A dhe B duhet të përbëjnë jo më pak se 70 % të totalit gjë që në planin mësimor të rishikuar 2018-2019 është përafëruar dhe shkon në 67.7%
- Lëndët me zgjedhje kanë 10 kredite, por zgjidhen jo nga vetë studentët, por në marrëveshje me Departamentin
- Tema e diplomës është 20 kredite pra rreth 6.7% bazuar në VKM Nr. 41 dt. 24.1.2018 duhet 3-5%



- *Shpërndarja e lëndëve sipas tipologjisë A, B, C, D, E, F ka pasaktësi si p.sh.: Lënda Farmaci fizike, e cila është lëndë integruese e programit është klasifikuar si disiplinë e formimit karakterizues, etj*

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit Master i Shkencave në “Farmaci” ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Departamenti i Farmacisë, i cili ka filluar aktivitetin e tij qysh në vitin 2010. Misioni dhe objektivi i programit të studimit në përgjithësi përputhet me përmbajtjen e programit. Në përfundim të studimeve studenti pajiset me Diplomë “**Master i Shkencave në Farmaci**” miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve me **Urdhër Nr.468 dt. 03.05.2013**, “Për akreditimin e programit të studimit që përfundon me “Master i Shkencave në Farmaci” të Shkollës së Lartë Universitare Jo-Publike “Aldent”. (akti 4). Ky program studimi ofron një Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë (DIND), sistem 5 vjeçar (10 semestra, 300 ECTS).

- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
➤ 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor

- Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë


Bazuar në RVB, dhe në gjetjet gjatë vizitës në Institucion, GVJ vëren se ky plan ka pësuar ndryshime në masën jo më shumë se 20% të tij.

Ky plan mësimor është ndryshuar me qëllimin e mirë për të përmbushur kriteret e kërkuara, por disa ndryshime janë të pabazuara në rolin e tyre për përmirësimin e mësimnxënies së studentëve si pasojë ka ende aspekte që duhen përmirësuar. Plani i studimit aktual për brezin 2018-2023 (shiko Aneksin 8)

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- | | |
|---------------------------------------|--|
| ▪ Për leksionet | 6-12 orë në auditor dhe 19-13 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Seminaret | 6-8 orë në auditor dhe 19-17 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Ushtrimet | 12-18 orë në auditor dhe 13-7 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Labororet | 18-25 orë në auditor dhe 7-0 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Praktikat lëndore | 20-25 orë në auditor dhe 5-0 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Praktikën Profesionale | 20-25 orë në auditor dhe 5-0 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Provimi përfundimtar (temë diplome) | 50 orë në auditor dhe 450 orë punë e pavarur e studentit |

- Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Tabela ne Aneks)
Bazuar në RVB, dhe në gjetjet gjatë vizitës në Institucion, GVJ vëren se ky plan ka pësuar ndryshime në masën jo më shumë se 20% të tij.



Ky plan mësimor është ndryshuar me qëllimin e mirë për të përmbushur kriteret e kërkuara, por disa ndryshime janë të pabazuara në rolin e tyre për përmirësimin e mësimnxënies së studentëve si pasojë ka ende aspekte që duhen përmirësuar. Plani i studimit aktual për brezin 2018-2023 (shiko Aneksin 8)

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Plotëso Tabelën në Aneks)

Në planet mësimore 2018-2019 në lidhje me personelin akademik GVJ **vëren se është plotësuar kriteri në lidhje me realizimin e 70%** të ngarkesës së programit të studimit nga PAE konkretisht (PAE realizon 3705 orë mësimore, pra 73%), dhe PAK (PAK realizon 1375 orë mësimore, pra 27%). Ndërsa numri i PAE kundrejt numrit të përgjithshëm të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi, konkretisht 14 personel akademik efektiv (PAE) nga 34 personel gjithsej, përbën më pak se 41% të tij, **pra nuk plotësohet kriteri në lidhje me numrin e stafit akademik efektiv. (Tabela 1 dhe 3)**

Situata në vitin akademik 2017-2018 në lidhje me planet mësimore kundrejt personelit akademik GVJ **vëren se është plotësuar kriteri në lidhje me realizimin e 70%** të ngarkesës së programit të studimit nga PAE konkretisht (PAE realizon 3701 orë mësimore, pra 79.5%) dhe PAK (PAK realizon 954 orë mësimore, pra 20.5%). Ndërsa numri i PAE kundrejt numrit të përgjithshëm të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi, konkretisht 20 personel akademik efektiv (PAE) nga 36 personel gjithsej, përbën 55.5% të tij, **pra nuk plotësohet kriteri në lidhje me numrin e stafit akademik efektiv. (Tabela 2 dhe 3)**

GVJ vëren se ka pedagogë që japin deri në 6 module apo 4 lëndë të ndryshme dhe që kanë ngarkesë përtej normës së një PAE bazuar në përputhje me gradë shkencore/titull akademik sipas Udhëzimit nr. 29 Dt. 10.9.2018 të MASR, duke çuar në mosprofilizimin e tyre në një lëndë të caktuar.

Planet mësimore të 6 viteve të fundit, në përgjithësi, janë të sigluara nga dekani dhe nga Rektori.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Syllabuset në përmbajtje janë në përputhje me objektivin e lëndës përkatëse. Janë të firmosura nga titullari, pedagogu i lëndës si dhe Përgjegjësi i Departamentit. *Kanë probleme të tilla ku shpesh i njëjti titullar firmos për rreth 4 lëndë, megjithëse mund të mos përputhet me CV-në e tyre.*

Gjithashtu në disa prej tyre janë parashikuar një numër orësh seanca laboratorike apo praktike, për të cilat nuk përshkruhet tematika. Në paragrafin mbi Detyrimet e studentit përcaktohet se ato duhen shlyer 100%.

Në syllabus ka të dhëna për ngarkesën e lëndës, literaturën, temat dhe gjithashtu dhe sistemin e vlerësimit. Studentët vlerësohen si gjatë vitit mësimor edhe në përfundim të tij. Studenti në përputhje me rregulloren duhet të frekuentojë 75% të leksioneve, 80% të seminareve dhe 100% laboratorët apo praktikatat për të fituar të drejtën të futet në provim në sezonin përkatës. Gjatë takimit me studentët sistemi i vlerësimit ishte qartë për ta. Literatura e detyruar mund të blihet ose të konsultohet në Bibliotekën e UAL.

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Syllabuset në përmbajtje janë në përputhje me objektivin e lëndës përkatëse. Kanë probleme të tilla si në një të tjetër prej tyre nuk vihet re firma e Lektorit apo titullarit, por vetëm ajo e Përgjegjësit të Departamentit; Periudha e zhvillimit të lëndës nuk përputhet me plan-programin mësimor viti akademik 2018-2019.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion u kërkuan dhe u dërguan Syllabuset për vitin akademik 2018-2019; CV e pedagogëve dhe titullarëve të lëndëve .

CV ishin të papërditësuara dhe të paplota.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” është akredituar në vitin 2013 me disa rekomandime. Ky program është i organizuar në module, të cilat vlerësohen në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë mund të grumbullojë gjatë një viti një sasi prej 60 kreditesh;</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinar, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion GVJ vëren se programi i studimit “Master i Shkencave në Farmaci” pranon studentë që zotërojnë një Diplomë Pjekurie, me notë mesatare mbi 6 dhe i pajis studentët me njohuri të thelluara, teoriko- praktike, trajnim profesional si dhe aftësi për kërkim shkencor.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Farmaci” i pajis studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike në fusha të ndryshme si anatomi, fiziologji, kimi, farmakologji, teknologji, legjisllacion etj, që përbëjnë bazën për shkencat farmaceutike. Ky program u jep studentëve njohuri specifike profesionale që lidhen me shërbimin farmaceutik si dhe trajnim profesional apo për kërkim shkencor në fushën farmaceutike. Pas përfundimit të studimeve si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për farmacinë, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesionit të farmacistit.</p>

<p>programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshatje me nivelin e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Duke u mbështetur në sa thuhet në RVB dhe në gjetjet gjatë vizitës në Institucion, GVJ vlerëson se përmbajtja dhe renditja e objektivave të programit të studimit Master i Shkencave në “Farmaci” synon përgatitjen e farmacistëve të ardhshëm të aftë për të punuar në sektorin privat apo shtetëror farmaceutik dhe është në përputhje me nivelin e studimeve.</p> <p>GVJ mbasi shqyrtoi RVB dhe dokumentat e marra gjatë vizitës në Universitetin “Aldent” vëren se metoda e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive në kombinim me provimet përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p> <p><i>Në programin e studimit janë përfshirë edhe projektet si element përbërës i planit mësimor pothuajse në të gjitha lëndët profesionale. Këto projekte në pjesën më të madhe kërkohen në vitin III dhe të IV. Aspekti pozitiv i këtij planifikimi është nxitja e aftësive krijuese dhe konsolidimi i sintezës së njohurive të studentit për fushën në studim.</i></p>
Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disaveçare dhe praktikatat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e tranferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomatat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se programi i studimit “Master i Shkencave në Farmaci” dhe aktivitetet ekstrakurrikulare mbështeten nga një marrëveshje bashkëpunimi me universitete europiane si ai i Chietit, Departamenti Farmaci nëpërmjet Qendrës Kërkimore Farmakoterapeutike për programin e studimit. Në këtë drejtim institucioni ka bërë përparime në kuadrin e programit ERASMUS + janë dërguar 2 studente si në kuadrin e shkëmbimit të studentëve dhe 1 pedagog si dhe 1 pedagog i Universitetit të Chietit ka zhvilluar periudhën e mobilitetit në Universitetin “Aldent”. <i>Këto mundësi duhet të rriten akoma më tej në drejtim të mobilitetit të stafit akademik si dhe përfitimin e granteve dhe projekteve të ndryshme.</i></p> <p>Programi i studimit “Master i Shkencave në Farmaci” është hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin farmaceutik shqiptar dhe direktivat mbi profesionet e rregulluara.</p>
Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se programi i studimit “Master i Shkencave në Farmaci” parahikon kryerjen e praktikës profesionale në 3 periudha nga të cilat 2 janë pjesë e semestrit I dhe 1 pjesë e semestrit II, gjithsej 520 orë. Nga llogaritjet e</p>

<p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>kryera rezultojnë se studenti duhet të kryejë 8 orë në ditë pra e gjithë praktika zhvillohet në 65 ditë pune ose 89 ditë kalendarike. 520 orë / 14 javë = 37.1 orë, çka është në kundërshtim me kriterin ligjor që shprehet se studenti nuk duhet të ketë më shumë se 25 orë ngarkesë javore. Me përfundimin me sukses të saj studenti fiton 25 kredite.</p> <p>Vlen të përmendet se në kuadrin e ndërkombëtarizimit të programit të studimit duhet mbajtur parasysh që standartet e shkollave europiane e kanë 5-6 muaj praktikën profesionale dhe studenti fiton 20-25 ECTS. <i>Mendojmë se është në të mirë të programit që të rritet shtrirja në kohë e zhvillimit të praktikës profesionale.</i></p> <p>Programi i studimit “Master i Shkencave në Farmaci” përputhet me profilin e Universitetit “Aldent” dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Bazuar në DVV dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se personeli akademik efektiv që angazhohet në programin e studimit Master i Shkencave në “Farmaci” është i angazhuar me përkushtim edhe në udhëheqjen temave të diplomave dhe realizimin e punimeve në Konferencat shkencore të organizuara nga Institucioni apo vetë studentët.</p>
<p>Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>N/A</p>
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Bazuar në RVB si dhe në vizitën në institucion, programi i studimit “Master i Shkencave në Farmaci” i ofruar nga UAL ka zhvilluar një studim mbi nevojat e tregut të punës në fushën farmaceutike.</p> <p>Nga ky studim nuk ka asnjë rezultat konkret. Jepen disa opinione në lidhje me perceptime individuale pa ndonjë sondazh të mirëfilltë. Nuk ka të dhëna sasiore mbi kërkesat e tregut të punës për të diplomuar në fushën farmaceutike. Si përfundim meqenëse ka mbetur degë e kërkuar dhe institucioni e ka vlerësuar si program studimi të vlefshëm për t’u vazhduar.</p> <p>Aktualisht frekuentohet nga 281 studentë për 2018-2019 (61 të regjistruar për herë të parë në vitin e parë) (Tabela 15)</p>
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave në Farmaci” i ofruar nga Universiteti “Aldent” në bazë të RVB si dhe nga vizita në institucion GVJ konstaton se i shërben formimit të figurave profesionale të afta për t’i shërbyer popullatës në tërësi dhe pacientëve në veçanti. Shëndeti i mirë i popullatës është një synim madhor kombëtar dhe si i tillë ky program i shërben këtij interesi. Kultura shëndetësore është një tjetër interes madhor kombëtar si pjesë e kulturës në tërësi të një kombi. Pikërisht në këtë</p>

	aspekt GVJ mendon se ky program studimi ndihmon në ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.	
Kriteri 1 Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;	N/A
Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.	N/A
Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).	Programi i studimit Master i Shkencave në “Farmaci” i ofruar nga UAL bën pjesë në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (DIND). Realizohet me 300 kredite europiane ECTS të shpërndara në 5 vite akademike . (60 ECTS/Vit) dhe përfundon me mbrojtjen e një teme diplome 20 ECTS (6.7%) dhe marrjen e diplomës “Master i Shkencave në Farmaci”.
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.	
Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;	Studentët informohen verbalisht mbi programin e studimit në vitin e parë me takime direkte. Atyre iu jepet edhe një broshurë e programit mësimor 5-vjeçar. Informacioni mbi modulet e syllabuset iu jepet nga pedagogët e lëndës ditën e parë të mësimin. Në programin e studimit “Master i Shkencave në Farmaci” që ofrohet nga UAL informacioni mbi të mund të gjendet edhe online.
Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.	
Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi	

Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;

Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.

Bazuar në DVV si dhe gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se programi i studimit “Master i Shkencave në Farmaci” në vitin akademik 2018-2019 është përmblyllur me temë diplome. Diplomimi me temë diplome është i rregulluar edhe me një Procedurë për tezën e diplomës përpos rregullores së Fakultetit të Shkencave Mjekësore, pra ka një manual mbi mënyrën e përgatitjes dhe paraqitjes së saj.

Nga plan programi mësimor i dorëzuar për vitin akademik 2018-2019 si dhe brezin 2018-2023 rezulton se diplomimi me temë diplome është tashmë një standart për këtë program studimi, në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015.

Bazuar në RVB, në vizitën e kryer në UAL si dhe në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në institucion dhe të dërguar prej tij në rrugë zyrtare pranë ASCAL për realizimin e programit të studimit Master i Shkencave “Farmaci” janë parashikuar 20 ECTS (6.7%), për zhvillimin dhe mbrojtjen e temës së diplomës, bazuar në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 (3%-5% ose 9-15 ECTS).

Vërehet se ka përputhje midis profilit të udhëheqësit dhe fushës së zhvillimit të mikrotezës.

1. Programi i studimit “Master i Shkencave në Farmaci” ofrohet në përputhje me misionin dhe strategjinë e Universitetit. Programi i studimit “Master i Shkencave në Farmaci” është hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin farmaceutik shqiptar dhe direktivat mbi profesionet e rregulluara.
2. Institucioni kryen studim tregu, por në këtë rast nuk sjell të dhëna konkrete. Kuotat e pranimit vendosen mbi bazën e kërkesës për këtë degë studimi.
3. *Programi i studimit finalizohet me temë diplome* për të gjithë studentët (41 studentë të diplomuar për vitin 2017-2018) me vlerë 20 kredite. Programi përfshin në sasinë e duhur praktikën profesionale, por GVJ sygjeron shtrirjen në kohë pasi studentit i duhet të qëndrojë 8 orë në farmaci gjatë periudhës së kryerjes së praktikës profesionale.
4. Literatura ofrohet në gjuhën shqipe, por fondi i teksteve specifike për farmacinë duhet rritur, po ashtu edhe numri i kopjeve në bibliotekë. Studentët informohen si në hyrje në lidhje me programin e studimit për Farmaci, edhe lëndë pas lënde në lidhje me syllabuset.
5. Bazuar në të dhënat e përfshira në RVB, bazuar në vizitën në institucion si dhe në takimin e drejtpërdrejtë me pedagogët, GVJ vlerëson se *duhet të përmirësohet raporti PAE/PAK* gjë që do t'i shërbejë rritjes së cilësisë së mësimdhënies. *Ka ende mospërputhje midis profilit të titullarit dhe lëndës përkatëse.* GVJ sygjeron të zbatohet Udhëzimi Nr. 29 dt 10.09.2018 mbi ngarkesën e pedagogëve me kohë të plotë, si dhe Udhëzimi Nr. 36 dt. 23.11.2018, gjë që do ndikonte në mësimdhënie edhe më cilësore.
6. GVJ vëren se nga ndryshimet e bëra në kurrikulën e Programin e Studimit është plotësuar kriteri në lidhje me realizimin e 73% të ngarkesës së programit të studimit nga PAE dhe 27% nga PAK. Nga ana tjetër ka ende vend për përmirësim siç janë:
 - Raporti në numër PAE/PAK.
 - Kohëzgjatja e praktikës profesionale duhet më e gjatë në përputhje me kreditet që ka 20 ECTS.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Bazuar në RVB, dhe vizitën në institucion si dhe dokumentacionin shtesë të dorëzuar GVJ vëren se mësimdhënia në Programin e studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” është e organizuar në leksione, seminare, laboratore, praktika, detyra kursi, projekte, provime semestrale, provime kursi, temë diplome. Aktiviteti i mësimdhënies pasqyrohet në regjistrat e grupeve përkatëse që plotësohen nga PAE dhe PAK dhe ruhet nga sekretaria mësimore. Studentët e një kursi ndahen në nëngrupe laboratorit ose seminari në zbatim të Udhëzimit të MAS dhe shfrytëzohen ambientet përkatëse të siguruar nga UAL. Kontrolli i njohurive bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe gjithëvjeto. Aktivizimi i studentëve në aktivitet e njësisë duhet të rritet.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet (Tabela e Planit në aneks):

Format e mësimdhënies kombinohen në formën e leksioneve, seminareve, ushtrimeve, laboratorëve, praktika, projekte dhe praktika profesionale. Leksionet e laboratorët përbëjnë 62.5% të totalit të ngarkesës mësimore, pra pjesën më të madhe (2090 kundrejt 1254 format e tjera të mësimdhënies). Janë përfshirë në format e mësimdhënies edhe projektet me 1-2 kredite dhe zënë 20 orë në total e shpërndarë në module të ndryshme.

- Format e kontrollit të njohurive

Bazuar në RVB, dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion gjatë vizitës në institucion format e kontrollit të mësimdhënies kombinohen në kontroll të vazhdueshëm dhe provim kursi. Në shumicën e lëndëve kontrolli i vazhdueshëm vlerësohet me 10-30%, frekuentimi vlerësohet me 10-20% dhe plotësimi i detyrimeve në laborator apo detyra kursi vlerësohet 10-20%, ndërsa provimi i kursit 60-80%.

- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Bazuar në RVB studentët angazhohen kryesisht në punimet shkencore të pedagogëve të veçantë apo në nivel Departamenti. Nga gjetjet gjatë vizitës në institucion GVJ vëren se studentët angazhohen kryesisht në punime shkencore për Konferencën studentore. *Duhet rritur përqindja e studentëve që angazhohen në aktivitetin e Departamentit të Farmacisë si dhe në komisione të ndryshme pasi bazuar në RVB rezultoni se janë aktivizuar maksimumi 58 studentë nga 281 që ka ky program studimi.*

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Bazuar në RVB dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion GVJ vëren se studentët e programit të studimit “Master i Shkencave në Farmaci” të ofruar nga Universiteti “Aldent” pranohen në këtë program mbasi kanë përmbushur kriteret e pranimit të përcaktuara me ligj. Ata duhet të zotërojnë një diplomë të maturës dhe mesataren mbi 6 sipas përcaktimit nga MASR. Institucioni zbaton VKM nr. 407 dt. 1.06.2016 për vendosjen e notës mesatare si kriter i hyrjes së studentëve në Universitet. Bazuar në RVB studentët e programit të studimit “Master i Shkencave në Farmaci” japin deri në diplomim provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare në nivel B1. GVJ vëren se studentët e programit të studimit “Master i Shkencave në Farmaci” informohen mbi përmbajtjen e këtij programi qysh në fillim të vitit të parë. Studenti i sapodiplomuar firmos për tërheqjen e diplomës, siç kërkohet në Udhëzimin e MAS nr. 37 duke shënuar emër, mbiemër, datë dhe firmë. Gjithashtu u konstatua se studentët e programit të studimit “Master i Shkencave në Farmaci” informohen mbi rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit.

Gjithashtu GVJ vëren se në kuadrin e tutoriatit janë caktuar disa pedagogë për të gjithë studentët e programit në fjalë. Si nga deklaratimet e stafit gjatë takimit me ta, po ashtu edhe nga takimi me studentët rezultojnë se sistemi i tutoriatit ndihmon në zgjidhjen e problematikave të hasura prej tyre gjatë procesit mësimor. Sipas DVV në tabelën me nr. 16 thuhet se 2 studentë kanë përfituar nga mobiliteti mes IAL-ve, në kuadrin e ERASMUS+. GVJ vëren se sekretaria mësimore ka të dhëna në lidhje me vlerësimin e studentëve hap pas hapi deri në diplomim, në lidhje me frekuentimin e tyre.

Përsa i përket praktikës profesionale Departamenti i Farmacisë në bashkëpunim me Urdhrin e Farmacistëve të Shqipërisë ndihmon studentët e këtij programi të përzgjedhin institucionin në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale. Nga 153 të diplomuar në vitet 2015-2019, 95 (62%) janë punësuar në përputhje me diplomën, ndërsa për të tjerët nuk ka të dhëna.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve

Bazuar në RVB dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se studentët e programit të studimit “Master i Shkencave në Farmaci” të ofruar nga UAL pranohen në këtë program mbasi kanë përmbushur kriteret e pranimit të përcaktuara me ligj. Ata duhet të zotërojnë një diplomë të maturës shtetërore dhe notë mesatare mbi 6.

Bazuar në numrat e matrikullimit të marra gjatë vizitës në institucion, për vitin akademik 2018-2019 në këtë program studimi për të gjithë ciklin (5 vite) rezultojnë 278 studentë gjithsej, nga ku 67 për herë të parë.

Numri i studentëve të regjistruar për këtë program studimi nga viti 2014-2019:

Programi i studimit Msc në "Farmaci"	Studentë regjistruar në vitin e Parë	Nota Mesatare
2014-2015	31	8.06
2015-2016	70	8.59
2016-2017	45	8.13
2017-2018	65	8.14
2018-2019	67	n.a.
Totali	278	

- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Në përgjithësi bazuar në RVB nota mesatare e studentëve në hyrje është mbi 7 dhe vihet re se kjo mbetet e tillë edhe në dalje me oshilacione të parëndësishme. (Tabela 18)

- Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare (Tabela e Planit në aneks):

Bazuar në RVB, dokumentat shtesë të kërkuara gjatë vizitës në institucion GVJ vëren se studentët e regjistruar për herë të parë në vitin e parë të programit të studimit Master i Shkencave në "Farmaci" të UAL, për vitin akademik 2018-2019, është **67 studentë**. Gjatë vizitës në institucion u deklarua se nota mesatare është mbi **6.5**, ndërsa në RVB deklarohet se programe të veçanta si Master i Shkencave në "Farmaci" është caktuar mbi 7

- Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Bazuar në dokumentin shtesë mbi temat e diplomave GVJ vëren se në vitin akademik 2017-2018 janë Diplomuar **41** studentë me temë diplome, por nuk ka të dhëna për notën mesatare.

- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Mobiliteti nga dhe drejt UAL është një proces i zakonshëm dhe e drejtë e të gjithë studentëve. Bazuar në RVB deklarohet se në kuadrin e transferimeve të studentëve në UAL, pasi i kanë filluar studimet në një IAL tjetër për programe të veçanta si Master i Shkencave në "Farmaci" është caktuar si kriter pranimi nota mesatare mbi 7. Nga takimi në sekretarinë mësimore, në kuadrin e vizitës në institucion u deklarua se *ka më shumë studentë që transferohen nga UAL drejt institucioneve të tjera të arsimit të lartë se sa studentë, që vijnë në UAL nga IAL brenda e jashtë vendit.*

- Të dhëna për punësimin e studentëve

Bazuar në të dhënat e RVB nga 153 të diplomuar në vitet 2015-2019, 95 (62%) janë punësuar në përputhje me diplomën, ndërsa për të tjerët nuk ka të dhëna. Këto të dhëna merren nga komunikimi

drejtëpërdrejtë i Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumni si dhe në bashkëpunim me Urdhrin e Farmacistëve të Shqipërisë.

Numri total të diplomuarve

Bazuar në të dhënat e RVB nga 153 të diplomuar në vitet 2015-2019

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Bazuar në të dhënat e RVB 95 studentë të diplomuar në periudhën 2015-2019 janë punësuar në përputhje me diplomën.

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Nuk ka të dhëna.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;	Bazuar në RVB dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion GVJ vëren se studentët e programit të studimit “Master i Shkencave në Farmaci” të ofruar nga Universiteti “Aldent” pranohen në këtë program mbasi kanë përmbushur kriteret e pranimi të përcaktuara me ligj. Ata duhet të zotërojnë një diplomë të maturës dhe mesataren mbi 6 sipas përcaktimit nga MASR.
Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;	Institucioni zbaton <i>VKM nr. 407 dt. 1.06.2016</i> për vendosjen e notës mesatare si kriter i hyrjes së studentëve në Universitet.
Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimi të përcaktuara nga institucioni;	
Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;	Bazuar në RVB studentët e programit të studimit “Master i Shkencave në Farmaci” japin deri në diplomim provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare në nivel B ₁ .
Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimi dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimi.	
Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.	

<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>GVJ vëren se studentët e programit të studimit “Master i Shkencave në Farmaci” informohen mbi përmbajtjen e këtij programi qysh në fillim të vitit të parë. Studenti i sapodiplomuar firmos për tërheqjen e diplomës, siç kërkohet në Udhëzimin e MAS nr. 37 duke shënuar emër, mbiemër, datë dhe firmë. Gjithashtu u konstatua se studentët e programit të studimit “Master i Shkencave në Farmaci” informohen mbi rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në gjetjet gjatë vizitës në Institucion studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të programit të studimit Master i Shkencave në “Farmaci”.</p> <p>Këto të dhëna merren nga komunikimi i drejtëpërdrejtë i Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumni si dhe në bashkëpunim me UFSH. Bazuar në të dhënat e RVB nga 153 të diplomuar në vitet 2015-2019, 95 (62%) janë punësuar në përputhje me diplomën. Nga gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se për arsye të ndryshme statistikat e punësimit nuk janë të plota.</p> <p><i>GVJ mendon se duhen gjetur mënyra të tjera për vazhdimin e bashkëpunimit me studentët e diplomuar, si p.sh.: përfshirja e tyre në aktivitetet e edukimit në vazhdim, apo në konferenca e seminare shkencore.</i></p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se Departamenti i Farmacisë ka filluar të mbajë të dhëna mbi punësimin e studentëve që diplomohen në programin e studimit “Master i Shkencave në Farmaci” në bashkëpunim me UFSH.</p> <p>Nga ana tjetër GVJ sygjeron se duhen bërë më shumë përpjekje për gjetjen e mënyrave për t’i patur këto të dhëna mbi punësimin e të gjithë të diplomuarve.</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se studentët e programit të studimit “Master i Shkencave në Farmaci” informohen mbi programin e studimit, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit nga Departamenti i Farmacisë, sekretaria mësimore si dhe Zyra e Këshillimit të karrierës dhe Alumni.</p> <p>Tutoriati me pedagogë gjatë vitit 2018 është përmirësuar</p>

<p>hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>duke shtuar numrin e pedagogëve të angazhuar me tutoriatin për të gjithë studentët e këtij programi; GVJ gjatë takimit me studentët konstatoi se, ata mund të informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit nga sekretaria mësimore. Ndërkohë që ka filluar të funksionojë edhe sekretaria online gjë që bën të mundur që ky informacion të jetë sa më lehtë i aksesueshëm prej studentëve;</p>
<p>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion GVJ vëren se sistemi i tutoriatit funksionon si duhet dhe studentët e konsiderojnë shumë të vlefshëm për zgjidhjen e problematikave të ndryshme të procesit mësimor. NJBSC me zhvillimin e pyetësorëve bën të mundur dëgjimin e zërit të studentëve në lidhje me procesin mësimor.</p> <p>Bazuar në RVB dhe gjatë vizitës në institucion, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit për studentët ka si objektiv të punës së saj orientimin e studentëve që do diplomohen, në lidhje me tregun e punës, si dhe mbajtjen e statistikave të punësimit.</p> <p>Bazuar në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se është Departamenti i Farmacisë në bashkëpunim me UFSH që ndihmon studentët e programit të studimit “Master i Shkencave në Farmaci” në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Në pranimin e studentëve programit të studimit “Master i Shkencave në Farmaci” të ofruar nga Universiteti “Aldent” bazuar në RVB dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion GVJ vëren se zbatohen kriteret e pranimi të përcaktuara me ligj. Ata duhet të zotërojnë një diplomë të maturës dhe mesataren mbi 6 sipas përcaktimit nga MASR. 2. GVJ konstaton se studentët e programit të studimit “Master i Shkencave në Farmaci” informohen mbi përmbajtjen e këtij programi që në fillim të vitit të parë. Më pas pedagogët përkatës informojnë studentët në lidhje me syllabuset, frekuentimin dhe mënyrën e vlerësimit të lëndëve apo moduleve përkatëse. 3. GVJ vëren se sekretaria mësimore e institucionit mban regjistra me listën e dorëzimit të diplomave, suplementit dhe listës përfundimtare të notave. Studenti i sapodiplomuar firmos për tërheqjen e diplomës. Sekretaria zbaton udhëzimet në fuqi në lidhje me shënimet dhe procedurat e fletëve të pavlefshme të regjistrave themeltare dhe atij të notave. GVJ vlerëson se ngritja e sekretarisë online, do ta bëjë edhe më të lehtë dhe të aksesueshëm për studentët e programit të studimit. 4. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se është Departamenti i Farmacisë në bashkëpunim me UFSH ndihmon studentët e programit të studimit “Master i Shkencave Farmaci” në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale dhe jo Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, pavarësisht se studentët mund të këshillohen apo informohen për 	

problematika të ndryshme nga kjo Zyrë dhe sekretaria mësimore.

5. GVJ thekson se Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit nuk ka arritur deri më tani të mbajë të dhëna të sakta mbi punësimin e studentëve pas diplomimit. Deri në vitin 2019 janë mbledhur të dhëna vetëm për 95 të diplomuar nga 153 që duhen. *GVJ mendon se duhet gjetur modalitete alternative për sigurimin e lidhjes së ndërsjelltë student/IAL.*
6. Nga gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se për arsye të ndryshme statistikat e punësimit nuk janë të plota. *GVJ mendon se duhen gjetur mënyra të tjera për vazhdimin e bashkëpunimit me studentët e diplomuar, si p.sh.: përfshirja e tyre në aktivitetet e edukimit në vazhdim, apo në konferenca e seminare shkencore.*

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.


10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Kur flitet për Arsimit të Lartë nuk mund të kuptohet ky institucion pa Kërkimin Shkencor. Po të shikojmë edhe vetë ligjin 80/2015 që rregullon këtë aktivitet ai titullohet “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”. Pra edhe aktiviteti i stafit akademik do të ndërthuret midis aktivitetit didaktik dhe kërkimit shkencor, pasi për momentin ende IAL nuk po i klasifikojnë stafet akademike të ndara në stafe kërkimore shkencore dhe ato të përkushtuara ndaj didaktikës. Është pikërisht kërkimi shkencor që nxjerr në pah vlerat e aktivitetit akademik për shoqërinë, kombin e më gjerë. Kërkimi shkencor është shumë i rëndësishëm edhe për rritjen profesionale të vetë stafit akademik. Prandaj është e kuptueshme që politikat e kërkimit shkencor të jenë pjesë e rëndësishme e strategjisë së një Institucioni të Arsimit të Lartë siç është edhe Universiteti “Aldent”. Bazuar në DVV dhe në gjetjet gjatë vizitës në UAL, GVJ vlerëson se në programin e studimit “Master i Shkencave në Farmaci” aktiviteti kërkimor shkencor bazohet në iniciativën individuale dhe në planin e aktiviteteve të IAL-së, apo të vetë Departamentit të Farmacisë. Mbështetja në këtë fushë është e limituar në ofrimin e mundësisë së botimit në revistën e UAL si dhe disa konferenca studentore ku në bashkëpunim me pedagogët përkatës studentët kanë paraqitur punimet e tyre, bashkëpunimi me IAL të tjera apo UFSH për organizimin e disa Konferencave Shkencore. *Praktika e mobilitetit të stafit akademik me qëllim kualifikimin dhe zhvillimin e kërkimit shkencor është e limituar. Për vitin 2018 ka një përprjekje për të zgjeruar mbështetjen që IAL i jep PAE, jo vetëm në kuadrin e programit Erasmus + ku 1 Pedagog ka përfituar nga mobiliteti i stafit akademik, por edhe me sponsorizimin e udhëtimeve apo pagesën e fee për pjesëmarrje në Konferenca Ndërkombëtare. Në këtë drejtim për momentin janë dy pedagoge që janë financuar nga IAL për pjesëmarrjen në një Konferencë ndërkombëtare.*

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:



Të dhëna për kërkimin shkencor (Tabelat ne aneks)

Bazuar në DVV gjatë vitit 2013-2019 personeli akademik me kohë të plotë i IAL ka 105 botime, ka 4 projekte të fituara dhe të zbatuara, ka organizuar 8 aktivitete shkencore, ndërkohë që nuk specifikohet sa i përkasin PAE së Departamentit të Farmacisë. Nga pedagogët janë përfshirë në kërkime shkencore individuale **20 studentë**. Nuk ka asnjë projekt të fituar apo Çmime Kombëtare të fituara. (Tabela 19 fq 62 RVB)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;	Bazuar në DVV, GVJ vëren se PAE i IAL ka publikuar për periudhën 2013-2019, rreth 105 botime.
Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	Bazuar në të dhënat e paraqitura në DVV, GVJ vëren se stafi akademik efektiv i programit të studimit "Master i Shkencave në Farmaci", nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e sektorit farmaceutik.
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;	Për momentin nuk ka mësimdhënie në gjuhë të huaj.
Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.	
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtjshëm të personelit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;	Bazuar në RVB dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se Institucioni organizon programe për kualifikimin e mëtjshëm profesional të personelit akademik sidomos në fushën e mësimdhënies;
Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtjshme brenda dhe jashtë vendit.	<i>Institucioni duhet t'i ofrojë më shumë mundësi infrastrukurore dhe financiare stafit akademik për t'u integruar në kërkimin shkencor brenda dhe jashtë vendit</i>
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.	
Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;	Bazuar në RVB dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se Institucioni mban një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi në trajtën e formularëve të performancës të plotëuar 2 herë në vit nga vetë PAE si dhe CV-të e përditësuara të tyre, të ruajtura në Departamentin e Farmacisë;
Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;	Institucioni mban një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të dorëzuar pranë Bibliotekës së AU;
Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë	

personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.

Institucioni ka marrë pjesë dhe ka zbatuar 4 projekte kërkimore gjatë vitit 2014-2019, ka organizuar 8 aktivitete shkencore.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Bazuar në RVB dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se Universiteti "Aldent" e ka pjesë të strategjisë së tij zhvillimin dhe mbështetjen e kërkimit shkencor, por është ende në hapat e para.
2. GVJ vlerëson se në programin e studimit "Master i Shkencave në Farmaci" aktiviteti kërkimor shkencor i është lënë në dorë iniciativës personale të stafit akademik të tij dhe disa aktiviteteve të planifikuara si; Konferenca studentore. Mbështetja në këtë fushë ka qenë e limituar në ofrimin e mundësisë për PAE të botojnë në revistën e UAL.

Institucioni duhet t'i ofrojë më shumë mundësi infrastrukturore dhe financiare stafit akademik për t'u integruar në kërkimin shkencor brenda dhe jashtë vendit.

Duhet të rrisë dhe të zhvillojë politikat mbështetëse për stafin akademik me qëllim rritjen e kërkimit shkencor, publikimeve dhe mobilitetit ndërkombëtar.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Universiteti "Aldent" ka realizuar një sërë marrveshjes bashkëpunuese me institucione arsimore e shkencore të vendit dhe të huaja; GVJ konstatoi një sërë marrveshjesh si me Institutin e Shëndetit Publik, Urdhërin e Farmacistëve nëpërmjet të cilave realizohet shkëmbimi i eksperiencave, por ku edhe studentët e Msc Farmaci arrijnë të njohin apo edhe të aplikojnë dijet e përfutuara gjatë ciklit të studimeve teoriko-praktike.

FSHM ka marrëveshje bashkëpunimi edhe me institucione arsimore të huaja si me Universitetin e Chietit Itali dhe nëpërmjet këtyre bashkëpunimeve arrihet të këmbehen eksperiencat në fushën e kurrikulave, praktikave mësimore dhe laboratorike; gjithashtu bashkërisht janë duke punuar edhe në hartimin më të detajuar edhe të projekteve të kërkimit shkencor.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (ploteso Tabelat ne aneks)

UAL ka te evidentuara një sërë aktivitetesh të realizuara në kuadër të bashkëpunimit me partnerë vendas dhe të huaj, të formës së leksioneve didaktike me lektorë të huaj, leksione të hapura, trainime të përbashkëta dhe pjesëmarrje në trainime shkencore.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (dhenat ne aneks)

Krahas marrëveshjeve të mëparshme (para vitit 2017) që janë rreth 9 me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, gjatë vitit 2017-2018 janë realizuar edhe 5 marrëveshje të tjera në fushën e kërkimit shkencor dhe bashkëpunimit institucional.

Këto marrëveshje bashkëpunimi tregojnë se UAL ka rritje sasiore dhe cilësore në bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar me institucione arsimore dhe kërkimore shkencore, të cilat janë një mundësi për të patur një zhvillim në të gjitha aspektet në Msc Farmaci.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>FSHM (Departamenti i Farmacisë) për rritjen e dijeve praktike të studentëve ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me Urdhrin e Farmacistëve dhe rretin e hapur farmaceutik, ku departamenti dhe drejtuesi teknik i farmacisë nënshkruajnë marrëveshje për çdo student dhe pjesën praktike që ata do të realizojnë; kjo veprimtari realizohet e dokumentuar.</p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Departamenti i Farmacisë dhe strukturat e tjera të FSHM kanë një veprimtari bashkëpunuese me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor etj.</p> <p>Çdo personel, krahas detyrave të shkruara në rregulloret respektive, kishte të qartë detyrat dhe detyrimet për vendin e punës dhe kompetencat e tij, duke i dhënë një garanci për cilësinë e mësimdhënies, nëpërmjet një bashkëpunimi korrekt.</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p>	<p>Departamenti i Farmacisë, Qendra Kërkimore Farmakoterapeutike kanë arritur që UAL të nënshkruajë një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Chietit, Itali, ku në kuadrin e programit Erasmus + kanë shkuar 2 studentë dhe 1 pedagoge dhe nga pala tjetër ka ardhur një studentë dhe 1 pedagog. Këto veprimtari shërbejnë si për ngritjen e nivelit të studentëve dhe për rritjen e kërkimeve shkencore apo botimeve tj.</p> <p><i>Duhet të punohet, që më shumë anëtarë të</i></p>

Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;

Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

personelit akademik shqiptar të kenë eksperiencën e tyre jashtë.

Nëpërmjet bashkëpunimit me Urdhrin e Farmacistëve realizohet bashkëpunimi me rrjetin e hapur farmaceutik për realizimin e praktikave mësimore të studentëve të Msc Farmaci.

Konkluzionet e vlerësimit:



1. Bazuar në RVB, dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ e vlerëson përpjekjen e Institucionit për të patur sa më shumë marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit për realizimin e objektivave të programit të studimit. *Duhet të punohet, që sa më shumë personel akademik shqiptar të kenë eksperiencën e tyre pranë institucioneve të huaja të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.*
2. Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet arsimore e kërkimore – shkencore kombëtare dhe ato ndërkombëtare bëjnë që Institucioni të synojë një rritje cilësore në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, nëpërmjet pjesëmarrjes së trupës pedagogjike dhe atyre të studentëve, në botime shkencore, vizita pune, pjesëmarrje në konferenca etj.
3. Praktikat mësimore, me një vlerë të veçantë për formimin e studentëve dhe zhvillimin e tyre profesional, realizohen në rrjetin e hapur farmaceutik bazuar në marrëveshje bashkëpunimi të qëndrueshme tashmë.

ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

Pikat e forta:

1. Ofrimi i programit të studimit Msc. "Farmaci" në zbatim të legjislacionit në fuqi, akteve normative të MASR, por njëkohësisht i përshtatur edhe me programe simotra të institucioneve vendase e të huaja. Së pari lehtëson mobilitetin e studentëve brenda e jashtë vendit dhe gjithashtu përgatit specialistë të shëndetit në fushën farmaceutike.
2. Infrastruktura e përshtatshme dhe sipas normativave për zhvillimin normal të procesit mësimor, praktikave laboratorike etj, për numrin e studentëve të këtij programi studimi, me një funksionalitet optimal.
3. Staf i akademik i kualifikuar dhe i përkushtuar për të dhënë në mësimdhënie dhe të vlerësuar nga studentët; staf që angazhohet në mënyrë të vazhdueshme për ecurinë e tij në kërkimin shkencor si dhe bashkëpunimi i ndërsjellë i trupës akademike në të gjitha hallkat e Departamentit të Farmacisë dhe FSHM për zhvillimin e procesit të mësimdhënies dhe rritjes cilësore të tij.
4. Realizimi i një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione vendase dhe të huaja në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Pika të dobëta:



1. Në disa raste vihet re një mbingarkesë e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi, tej normës së përcaktuar në udhëzimet e MASR. Vërehen raste ku pedagogë angazhohen në më shumë se 2 lëndë vjetore apo 3 module semestrare.
2. Përfshirje e ulët e stafit akademik dhe e studentëve të këtij programi studimi në programet e Mobilitetit.
3. Projektet kërkimore janë akoma në numër të pakët, kërkohet më shumë angazhim dhe mbështetje financiare për kërkimin shkencor.

Mundësitë:

1. Rishikimi i kurikulës së programit të studimit.
2. Institucioni ka kapacitet për të gjeneruar të ardhura nga burime të tjera, duke zhdërvjelltësuar procedurat dhe duke ofruar shërbime për të tretë, sidomos nëpërmjet Qendrës Kërkimore Farmakoterapeutike.
3. Rritja e mundësive të stafit akademik për të përfituar nga programet e ndërsjella të shkëmbimit me universitetet partnere.
4. Ndërtimi i kampusit të ri.

Pengesat:

1. Mbështetja financiare e zhvillimit të kërkimit shkencor, por duke patur të ardhura vetëm nga tarifat e studimit do të ishte një pengesë.
2. Vendodhja e godinave, ku zhvillohet programi i studimit, në distanca të konsiderueshme përbën sërish një pengesë.

Rekomandime për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit:

1. GVJ rekomandon rishpërndarjen e ngarkesës mësimore për të arritur një raport ngarkesë kundrejt gradë/titull në respekt të standarteve dhe udhëzimeve më të fundit të MASR. Kjo do të rriste cilësinë e mësimdhënies dhe do të mundësonte ngritjen profesionale të stafit më të ri të këtij programi studimi. Duke marrë parasysh mbingarkesën e pedagogëve të brendshëm dhe atyre të jashtëm GVJ rekomandon afrimin e më shumë stafi me tituj akademik për të ulur numrin e lëndëve që mbulon i njëjti titullar si dhe përputhjen me profilin përkatës.
2. GVJ rekomandon rishikimin e planit mësimor për të ulur ngarkesën në disa lëndë të rëndësishme të këtij programi studimi, që janë ngjeshur brenda të njëjtit vit, si Teknologji Farmaceutike II, III, Përgatitje Galenike e Kozmetike, të gjitha në vitin e IV, si dhe përfshirjen e laboratorëve apo praktikave në lëndë të tilla si Fiziologjia, etj. Kjo do të çonte në rritjen e përgatitjes nga ana praktike të studentëve.
3. GVJ rekomandon shtimin e buxhetit për kërkimin shkencor. GVJ rekomandon që QKF të vihet në efikasitet të plotë duke kryer edhe shërbime për të tretë, gjë që do sillte të ardhura shtesë për institucionin dhe programin studimit.
4. GVJ sygjeron rritjen e numrit të marrëveshjeve me institucione të huaja të arsimit të lartë për t'u dhënë mundësi një numri sa më të madh studentësh dhe pedagogësh të përfitojnë prej tyre. Kjo do t'i shërbente rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.
5. GVJ sygjeron përditësimin e dokumentacionit të stafit akademik të këtij programi studimi.
6. GVJ rekomandon rishikimin e shtrirjes në kohë të praktikës profesionale, për t'u përafëruar me shembujt më të mirë europianë në këtë drejtim.

SUMMARIZING ANALYSIS ACCORDING TO THE SWOT METHOD (STRENGTHS, WEAKNESSES, OPPORTUNITIES, THREATS).

Strengths

1. Overall the study programme Msc. "Pharmacy" is offered according to the actual legislation, normative acts of MASR, but at the same time in line with the programme of other national and foreign sibling institutions. This eases the mobility of students in- and outside our country and prepares health specialists in the pharmaceutical field.
2. A suitable infrastructure based on the appropriate normative for a normal didactic process, laboratory sessions etc. Based on the number of students registered in this programme actually it has an optimal functionality.
3. The academic staff is qualified and dedicated to the teaching activity, appreciated by their students too; engaged continuously in activities for their own upgrade and the development of scientific research; the collaboration between the Department of Pharmacy, Faculty of Medical Sciences and members of academic staff in every way.
4. Having some mutual collaboration agreements with national and foreign institutions to increase the quality of teaching and scientific research.

Weaknesses

1. There are several cases of academic staff giving more teaching hours than the MASR's Guidelines recommend. Some of the academic staff teach in more than 2 annual subjects or 3 modules as they should according to MASR's Guidelines.
2. There are involved a low number of academic staff and students, of this study programme, in the mobility programmes.
3. The low number of research projects, there are needed more efforts and financial support for the scientific research.

Opportunities


5. Revision of the curricula of this study programme.
6. The institution has the capacity to generate incomes from other sources rather than only the school fee. It can operate through more flexible procedures, it can offer services for third parties especially via Pharmaco-therapeutic Research Center (Q.K.F.).
7. Increasing opportunities of academic staff to take advantage of mutual exchange programmes with partner universities.
8. Building a new campus.

THREATS

1. The financial support for the development of scientific research, but having study fees as the only source of income would be considered a threat.
2. The location of two buildings, where the students should attend different subjects of this study programme, is in considerable distance from each other.

Recommendations

1. External Evaluation Group (GVJ) recommends the spread of teaching hours in respect of grade/title standards and the Guidelines of MASR. This will bring quality increase in teaching



- and give the youngest member of the academic staff the opportunity to increase their professional achievements. Taking into consideration the amount of extra-hours, of intern- and extern-academic staff, recommends an increase of efforts of the institution to approach more staff with academic title to improve the situation of responsible staff of certain subjects.
2. External Evaluation Group (GVJ) recommends the revision of teaching programme for different important subjects of this study programme such as Pharmaceutical Technology II, Pharmaceutical Technology III, Galenic and Cosmetic Preparations, which are part of the same academic year; inserting laboratory or practice sessions in subjects such as Physiology, etc. This change will aim for students to become more prepared from the practical point of view.
 3. External Evaluation Group (GVJ) recommends increase of budget for the scientific research. It recommends for Pharmaco-therapeutic Research Center (QKF) to become more efficient performing services for third parties which will bring extra incomes for the institution and this study programme.
 4. External Evaluation Group (GVJ) recommends the increase of number of mutual agreements with foreign high education institutions, aiming to give the opportunity of taking advantage of them to more students and staff. This practice would lead to increase of teaching and scientific research quality.
 5. External Evaluation Group (GVJ) recommends the update of the documentation on academic staff of the study programme.
 6. External Evaluation Group (GVJ) recommends for the Professional Practice to be extended in time, to become more close to the best European examples in this field.

Two handwritten signatures in blue ink are located at the bottom right of the page. The signature on the left is more cursive and includes a date-like structure, possibly '01/11/2019'. The signature on the right is a large, stylized, looped signature.